



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 485 Akti

Nr. 663 Vendimi
Tiranë, më 23.5.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 22.5.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Dritan Caka**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesen ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Dritan Caka, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Dritan Caka ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit u shortua me shortin e datës 15.6.2020 dhe do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja (kryesuese), Suela Zhegu (anëtare) dhe Alma Faskaj (relatore), ndërsa si vëzhgues ndërkombëtar u caktua znj. Elka Ermenkova.
3. Në datën 26.1.2021, me kërkesë të saj, u miratua dorëheqja e anëtares së trupit gjykues, znj. Alma Faskaj, për shkak të situatës së konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit Dritan Caka dhe nëpërmjet procedurave të shortimit anëtari i ri i trupit gjykues u zgjodh komisionieri Olsi Komici.
4. Me vendimin e datës 16.2.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Dritan Caka për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; rivlerësimi i aftësive profesionale. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike¹, ku iu komunikua përbërja e trupit të ri gjykues dhe iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit. Subjekti² deklaroi se nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.
5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); Grupi i Punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
6. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm,

¹ Subjekti u njoftua po në datën 16.2.2021 me anë të postës elektronike me *email*.

² Subjekti i rivlerësimit, në datën 17.2.2021, njoftoi Komisionin me anë të postës elektronike.

me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Dritan Caka, si dhe njoftimin e tij për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 8.5.2023³ mbi rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfuara nga hetimi kryesisht zhvilluar nga Komisioni, duke i lënë afat deri në datën 17.5.2023. Subjekti i rivlerësimit, brenda afatit të lënë nga Komisioni, ka dërguar me postë elektronike (*email*) shpjegimet dhe provat përkatëse.

9. Subjekti i rivlerësimit, në datën 18.5.2023, u ftua në seancën dëgjimore, e cila u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 22.5.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashtrori shpjegimet e tij. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit Dritan Caka kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

10. Z. Dritan Caka ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

11. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

12. ILDKPKI-ja⁴, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të

³ Komunikimet ndërmjet Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit janë bërë me rrugë elektronike, me *email*.

⁴ Raporti nr. *** prot., datë 24.9.2018, i ILDKPKI-së.

rivlerësimit Dritan Caka, i cili është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2003, me nr. indeksi ***, duke konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje pasurie;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

13. Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

14. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacionet e marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjektit të rivlerësimit i janë njoftuar rezultatet e hetimit mbi asetet e deklaruara prej tij në deklaratën e pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

Mbi asetet e deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë *Vetting*

Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit

1. Apartament banimi me sip. 85.4 m², e ndodhur në rrugën “**”, Tiranë,** blerë me çmimin 3,279,360 lekë. Lidhur kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “****” sh.p.k., në datën 20.1.2005 dhe më pas kontrata e shitjes datë 20.2.2010⁵. Regjistruar në ZVRPP-në Tiranë⁶, me pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: (a) paguar shuma 2,500,000 lekë nëpërmjet një kredie të marrë në “Tirana Bank”, Lushnjë, me kontratën e huas datë 11.4.2005⁷, e shlyer plotësisht deri në vitin 2013; (b) pjesa e mbetur e çmimit paguar *cash* nga kursimet familjare.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

1.1 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të pasurisë së vitit 2005 (në vijim DIPP) me të njëjtat të dhëna si në deklaratën *Vetting*⁸.

⁵ Kontrata e shitjes nr. ***, datë 20.2.2010.

⁶ Me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***.

⁷ Kontrata e huas nr. ***, datë 11.4.2005, e lidhur me “Tirana Bank”.

⁸ “Apartament banimi në Tiranë, në rrugën “****”, me sip. 85.4 m², kati i 2-të teknik. Porositur tek sipërmarrësi “****” sh.p.k. Ende i paregjistruar në ZRPP nga sipërmarrësi. Nuk është lidhur ende kontrata e shitjes. Kontratë sipërmarrjeje datë 10.1.2005, me “****” sh.p.k. Shuma totale e kontratës së sipërmarrjes 27,328 euro, me pjesë takuese 100%. 5,328 euro paguar më 20.1.2005 nga kursimet e viteve të punës si gjyqtar dhe të ardhurat e deklaruara. 20,000 euro kredi tek “Tirana Bank” paguar në datën 11.4.2005. Pjesa e mbetur e shumës së kontratës së sipërmarrjes do të paguhet kur do të lidhet kontrata e shitjes”.

1.2 Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting*, ka rezultuar se ky apartament është përfituar nga kontrata e sipërmarrjes e datës 20.1.2005, e lidhur me shoqërinë sipërmarrëse “****” sh.p.k. (përfaqësuar nga administratori i saj A. S.). Objekt i kësaj kontrate ishte ndërtimi i apartamentit me sip. 85.4 m², me vlerë totale 27,328 euro, e cila do të paguhej nga porositësi (subjekti Dritan Caka), si vijon: (a) kësti i parë prej 5,328 euro është likuiduar në datën e lidhjes së kontratës; (b) kësti i dytë prej 20,000 euro do të paguhej nga porositësi deri në datën 20.4.2005; (c) pjesa e mbetur prej 2,000 euro do të paguhet në ditën kur palët të lidhin kontratën përfundimtare të shitjes.

1.3 Në vijim, subjekti i rivlerësimit, në datën 20.2.2010, ka lidhur kontratën e shitblerjes për këtë apartament, me çmimin 27,328 euro ose 3,279,360 lekë. Në kontratën e shitjes përcaktohej se kjo shumë është likuiduar paraprakisht në formë këstesh gjatë ndërtimit të apartamentit (sipas kontratës së sipërmarrjes). Pjesa e mbetur e çmimit të shitjes prej 2,000 euro është likuiduar nga blerësi ditën e lidhjes së kontratës së shitblerjes, jashtë zyrës noteriale dhe palët deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim pronësie apo financiare ndaj njëra-tjetrës. Në datën 5.4.2010, ZVRPP-ja Tiranë ka lëshuar certifikatën për vërtetim pronësie në emër të z. Dritan Caka.

1.4 Subjekti i rivlerësimit, në pyetësin nr. 2, ka shpjeguar se kësti i parë prej 5,328 euro është paguar *cash* në datën e lidhjes së kontratës, 20.1.2005, dhe si dokument ligjor ka shërbyer vetë kjo kontratë. Nga ana e shoqërisë, kur bëhej pagesa në ambientet e zyrës, lëshoheshin mandatarkëtime të thjeshta, të cilat për shkak të kohës së kaluar nuk janë ruajtur dhe subjekti gjendet në pamundësi objektive për t’i paraqitur si prova. Kësti i dytë prej 20,000 euro është paguar nëpërmjet kredisë që subjekti ka marrë në “Tirana Bank”, sipas kontratës përkatëse të datës 11.4.2005. Ndërsa kësti i tretë prej 2,000 euro është paguar në datën e lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes, 20.2.2010, dhe si dokument ligjor për vërtetimin e kësaj pagese shërben vetë kjo kontratë.

1.5 Shoqëria “****” sh.p.k.⁹ në përgjigjen e saj drejtuar Komisionit konfirmon se ajo nuk disponon dokumentacionin e dosjes së “objektit”, ku z. Dritan Caka ka qenë klient. Shoqëria ka ndryshuar adresën e saj dhe gjatë lëvizjeve një pjesë e dosjeve ka humbur, kjo për shkak të problemeve të brendshme të shoqërisë.

1.6 Komisioni gjatë hetimit ka administruar edhe përgjigjen e Agjencisë Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK), Drejtoria Vendore Tirana Veri¹⁰, e cila konfirmon të regjistruar në emër të z. Dritan Caka pasurinë apartament me sip. 85.4 m², shk. ***, k. ***, ap. ***. Në kartelën e pasurisë pasqyrohet adresa rruga “****”, Tiranë¹¹, ndërkohë në ILDKPKI subjekti ka depozituar kartelën e pasurisë kur apartamenti ishte në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k., me adresë rruga “****”.

1.7 Subjekti, në pyetësin standard, në lidhje me adresën e pasqyruar ndryshe në kartelën e pasurisë dhe ndryshe në certifikatën për vërtetim pronësie, ka shpjeguar, ndër të tjera, se regjistrimi i apartamentit ku banon që nga muaji maj 2005 është bërë fillimisht me adresë të pasaktë pranë ish-ZVRPP-së Tiranë nga shoqëria ndërtuese, pasi ai figuronte në rrugën “****”, Tiranë, ndërkohë

⁹ Përgjigje nr. *** prot., datë 9.12.2022, e shoqërisë “****” sh.p.k. drejtuar Komisionit.

¹⁰ Përgjigje nr. *** prot., datë 16.2.2021, e ASHK Tirana Veri.

¹¹ Z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***.

që ndodhet në të vërtetë në rrugën “****”, Tiranë. Ky fakt provohet nga Urdhri i Korigjimit i Regjistruesit të ish-ZVRPP-së Tiranë, i shënuar në kartelën e pasurisë së paluajtshme për pasurinë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, të lëshuar në datën 5.4.2018, për korigjimin e kësaj pasaktësie në adresë.

1.8 Nga përgjigjja e Furnizuesit të Shërbimit Universal (në vijim FSHU)¹² konfirmohet abonenti Dritan Caka, me kontratë ***, në kategorinë familjare me datë hapjeje 28.6.2005, me adresë kabine që i korrespondon rrugës “****”.

1.9 Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 85.4 m², duke e krahasuar me çmimin referues të EKB-së të përcaktuar në udhëzimin e vitit 2005¹³. Udhëzimi referon se nga të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve për vitin 2005 për qytetin e Tiranës përcaktohet çmimi 77,452 lekë/m². Duke përlogaritur sipërfaqen 85.4 m² x 77,452 lekë/m² = 6,614,400 lekë, ndërsa vlera e kontratës së shitjes është 3,279,360 lekë, rezulton se subjekti e ka blerë këtë apartament me çmim më të ulët krahasuar me çmimin referues të EKB-së.

1.10 Komisioni, nisur nga fakti se midis çmimit të blerjes së apartamentit dhe çmimit referues të EKB-së ka diferencë në vlerë, me pyetësonin nr. 2 i ka kërkuar subjektit të shpjegojë në lidhje me këtë diferencë, si dhe të depozitojë kontrata të ngjashme të lidhura në atë vit apo në periudha të përafërta kohore me kohën e blerjes së apartamentit me sip. 85.4 m², nga shoqëria “****” sh.p.k. me individë të tjerë.

1.10.1 Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se çmimi i përcaktuar në kontratë është arritur pas negociatave të bëra me administratorin e shoqërisë “****” sh.p.k. Në përcaktimin e çmimit është mbajtur parasysh fakti se pallati ndodhej në një zonë jo të preferuar në Tiranë, ishte zonë e pasistemuar dhe aksesit në infrastrukturën publike nuk ishte i lehtë. Apartamenti i ofruar ishte i fundit dhe nuk ishte prenotuar nga persona të tjerë, për shkak se kishte sipërfaqe të vogël dhe strukturë të papërshtatshme, që e bënte jo të shfrytëzueshëm për qëllime jetese. Gjithashtu, edhe pozicioni i tij nuk ishte i përshtatshëm në krahasim me apartamentet e tjera¹⁴.

1.10.2 Subjekti i rivlerësimit, për të provuar se çmimi i blerjes së apartamentit të tij nga shoqëria “****” sh.p.k. nuk është çmim preferencial, ka depozituar dy kontrata sipërmarrjeje:

i) Kontrata e sipërmarrjes datë 25.10.2004, lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit R. M., për apartamentin me sipërfaqe banimi 103.2 m² + verandë me sip. 61.2 m² = 164.4 m², me

¹² Përgjigje nr. *** prot., datë 1.12.2022, e FSHU-së.

¹³ Udhëzimi nr. ***, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2005”.

¹⁴ Përgjigjja e pyetjes 7 të pyetësonit nr. 2: “Çmimi i përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes së datës 20.1.2005, për blerjen e këtij apartamenti është përcaktuar mbi bazën e marrëveshjes që kemi arritur pas negociatave të zhvilluara me administratorin e shoqërisë “****” sh.p.k. Në përcaktimin e këtij çmimi është patur parasysh fakti se zona ku ndodhet pallati i ndërtuar prej shoqërisë “****” sh.p.k. (ku jetoj edhe aktualisht bashkë me familjen) nuk përfshihet tek ato të preferuarat për ndërtim në qytetin e Tiranës, pasi nuk ishte e sistemuar dhe aksesit në infrastrukturën publike nuk ishte i lehtë, për shkak të rrugës së ngushtë dhe ndërtimeve të afërta ekzistuese. Po kështu, apartamenti që më është ofruar për të lidhur kontratë sipërmarrjeje nga shoqëria *** sh.p.k., me sa mbaj mend, ka qenë i fundit që kishte mbetur pa u prenotuar nga persona të tjerë. Kjo për shkak se ky apartament kishte sipërfaqe të vogël, ndërkohë që korridori në hyrje është shumë i ngushtë dhe në formë të tillë që shpenzon një pjesë të sipërfaqes së apartamentit pa qenë i shfrytëzueshëm për qëllime jetese. Përveç kësaj, edhe pozicioni në të cilin ndodhet apartamenti në pallat nuk konsiderohej i përshtatshëm, në krahasim me apartamentet e tjerë”.

çmim 50,000 euro (çmimi për metër katror llogaritet $50,000 \text{ euro}/164.4 \text{ m}^2 = 304 \text{ euro}/\text{m}^2$ dhe në variantin më të mirë, në qoftë se konsiderohet çmimi i shitjes së verandës me $\frac{1}{2}$ e çmimit të shitjes së apartamentit, sikurse ka qenë praktika e shitjes së verandave nga shoqëritë e ndërtimit, çmimi i shitjes së kësaj pasurie rezulton të ketë qenë $373,7 \text{ euro}/\text{m}^2$ ($50,000 \text{ euro} : 133.8 \text{ m}^2 = 373.7 \text{ euro}/\text{m}^2$).

ii) Kontrata e sipërmarrjes datë 12.10.2004, lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit A. G., për apartamentin me sipërfaqe banimi 110.61 m^2 dhe apartamentin me sipërfaqe banimi 63.22 m^2 + garazh, pa përcaktuar sipërfaqe, me çmimin 80,000 euro (Çmimi për metër katror llogaritet $80,000 \text{ euro}/173.83 \text{ m}^2 = 460 \text{ euro}/\text{m}^2$. *Sqarojmë që kësaj vlere duhet t'i zbritet edhe çmimi i garazhit, i cili është i përfshirë në çmimin total të shitjes prej 80,000 euro*).

1.11 Komisioni, në vijim të hetimit për çmimin e apartamentit, ka verifikuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe administratorin e saj A. S. Për këtë qëllim janë administruar përgjigjet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës¹⁵, ku nuk u konstatua që subjektet e mësipërme të kenë pasur procese gjyqësore në këto dy gjykata. Ndërsa nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁶ konfirmohet se shoqëria “****” sh.p.k. dhe administratori i saj A. S. kanë pasur për gjykim pranë kësaj gjykate çështje civile, por këto çështje janë gjykuar nga gjyqtarë të tjerë¹⁷ dhe jo nga subjekti i rivlerësimit dhe në përfundim nuk u konstatua situatë konflikti interesi.

Komisioni ka analizuar burimet e krijimit të apartamentit me sip. 85.4 m^2

1.12 Burimi i parë, që është huaja prej 2,500,000 lekësh, marrë në “Tirana Bank”, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2005, me qëllim financimin e ndërtimit të apartamentit.

1.13 Subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar kontratën e huas datë 11.4.2005¹⁸, lidhur me “Tirana Bank”, ku subjekti është në cilësinë e huamarrësit dhe shtetasit H. e A. Xh., në cilësinë e dorëzanësit. Banka i jep hua z. Dritan Caka shumën prej 2,500,000 lekësh, e cila sipas kontratës do të përdoret për blerjen e një apartamenti në Tiranë. Huaja është dhënë për një periudhë 20-vjeçare, deri më 11.4.2025 dhe sigurimi i shlyerjes së saj do të garantohet nga hipoteka mbi pasurinë e paluajtshme të llojit truall me sip. 300 m^2 , mbi të cilin është ndërtuar ndërtesa 2 kate + papafingo, me sip. 148 m^2 , e regjistruar në ZVRPP-në Lushnjë, në pronësi të shtetasit H. Xh.

¹⁵ Përgjigje nr. *** prot., datë 23.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe nr. *** prot., datë 22.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

¹⁶ Përgjigje nr. *** prot., datë 30.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁷ Vendimi nr. ***, datë 11.3.2016, gjykuar nga gjyqtari A. A.; vendimi nr. ***, datë 3.3.2017, gjykuar nga gjyqtari A. K.; vendimi nr. ***, datë 19.4.2018, gjykuar nga gjyqtari N. R.; vendimi nr. ***, datë 26.2.2019, gjykuar nga gjyqtari T. H.; vendimi nr. ***, datë 13.10.2020, gjykuar nga subjekti E. P.; vendimi nr. ***, datë 17.3.2021, gjykuar nga gjyqtari A. K.; vendimi nr. ***, datë 20.10.2022, gjykuar nga gjyqtari A. Zh.; vendimi nr. ***, datë 17.9.2021, gjykuar nga gjyqtari A. K.

¹⁸ Kontrata e huas afatgjatë nr. ***, datë 11.4.2005, lidhur me “Tirana Bank”.

1.14 “Tirana Bank”¹⁹ konfirmon se kredia bankare prej 2,500,000 lekësh, e cila është disbursuar në datën 14.4.2005 në llogarinë e subjektit të rivlerësimit dhe në të njëjtën datë ka paguar shumën 2,526,000 lekë për shoqërinë “***” sh.p.k., me kursin e këmbimit të euros për 126.3 lekë. Pra subjekti ka paguar 20,000 euro nëpërmjet transfertës, me burim kredinë bankare dhe me vërtetimin nr. ***, datë 9.1.2017, konfirmon se huaja prej 2,500,000 lekësh është shlyer plotësisht nga z. Dritan Caka.

1.15 Komisioni ka verifikuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit me shtetasit H. dhe A. Xh. në cilësinë e dorëzanësve dhe, për këtë qëllim, ka administruar përgjigjet e gjykatave të rretheve gjyqësore Lushnjë, Durrës dhe Tiranë, ku nga verifikimi nuk u konstatua një situatë e tillë.

1.16 Në lidhje me burimin e dytë “paguar cash nga kursimet familjare”, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, për këstin e parë prej 5,328 euro të paguar në datën 20.1.2005 në DIPP-në e vitit 2005, ka deklaruar si burim krijimi *kursimet e viteve të punës si gjyqtar dhe të ardhurat e deklaruara*. Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime *cash* në shumën 800,000 lekë, ndërsa në DIPP-në e vitit 2004 ka deklaruar 600,000 lekë kursime për vitin 2004. Nga leximi i deklaratave periodike vjetore rezulton se më 31.12.2004 subjekti ka pasur gjendje 1,400,000 lekë kursime *cash*. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve *cash*, por kur ka deklaruar pasurinë në këtë deklaratë ka përcaktuar si burim për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit në datën 20.1.2005, kursimet ndër vite.

1.16.1 Subjekti i rivlerësimit, me anë të pyetësorit nr. 2, është pyetur të shpjegojë se cilave likuiditeteve i referohet kur deklaroi në DIPP-në e vitit 2005 si burim për pagesën e shumës 5,328 euro, të datës 20.1.2005, “kursimet e viteve të punës si gjyqtar dhe të ardhurat e deklaruara”. Subjekti ka shpjeguar se për kryerjen e pagesës së këstit të parë për blerjen e apartamentit, në bazë të kontratës së sipërmarrjes datë 20.01.2005, të lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k., janë përdorur një pjesë e të ardhurave të deklaruara si gjendje *cash* deri në datën 31.12.2004.

1.16.2 Komisioni, duke iu referuar mënyrës se si ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2005, e ka konsideruar shumën 1,400,000 lekë si burim, të cilin subjekti e ka përdorur në datën 20.1.2005 kur ka paguar 5,328 euro ose 639,360 lekë²⁰. Sipas deklaratës të subjektit në DIPP-në e vitit 2005, me të vërtetë ai nuk ka deklaruar pakësimin e kursimeve *cash* për pagesën e këstit të parë prej 5,328 euro, por ka deklaruar saktë burimin e pagesës 5,328 euro kur ka deklaruar pasurinë apartament dhe burimet e pagesave të saj në të njëjtën deklaratë.

1.16.3 Komisioni vëren se mosdeklarimi i pakësimit të kursimeve *cash* në DIPP-në e vitit 2005 konsiderohet si pasaktësi në deklaratë në kuadër të ligjit nr. 84/2016, por duke qenë se pagesa e kësaj shume është bërë në janar të vitit 2005, me burim të deklaruar saktë “kursimet e viteve të punës si gjyqtar dhe të ardhurat e deklaruara” (duke nënkuptuar qartë kursimet *cash* ndër vite) dhe subjekti ka bërë deklaratën pasardhëse në mars të vitit 2005 dhe ka pasur burime të mjaftueshme

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 11.12.2020, e “Tirana Bank”.

²⁰ Konvertuar me kursin e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes së datës 20.1.2005.

për të paguar këstin, konsiderohet si pasaktësi në deklaram në kuadër të ligjit nr. 84/2016, me një peshë të papërfillshme, që nuk e penalizon subjektin e rivlerësimit, për sa i përket kriterit të pasurisë.

1.16.4 Kursimet *cash* të akumuluar nga subjekti i rivlerësimit deri më 31.12.2004, në shumën 1,400,000 lekë, duket se janë të mjaftueshme për të paguar këstin e parë prej 5,328 euro ose 639,360 lekë, në datën 20.1.2005. Analiza financiare për vitet 2003 – 2004 ka rezultuar me balancë pozitive, çka justifikon ligjshmërinë e kursimeve *cash* të përdorura për pagesën e këstit.

1.16.5 Në lidhje me pagesën e këstit të tretë prej 2,000 euro, subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në e vitit 2010, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, deklaroi: “*Shlyer detyrimi i mbetur prej 2,000 euro shoqërisë “***” sh.p.k., në bazë të kontratës së sipërmarrjes të datës 20.1.2005, për ndërtimin e apartamentit...*”.

1.16.6 Subjektit të rivlerësimit, me anë të pyetësorit nr. 2, iu kërkua të përcaktojë burimin e ligjshëm të kësaj shume dhe datën e saktë të kryerjes së saj. Subjekti ka shpjeguar se për pagesën e këstit prej 2,000 euro janë përdorur një pjesë e kursimeve në gjendje *cash*, të realizuara nga paga e subjektit dhe bashkëshortes përpara datës 20.2.2010.

1.16.7 Komisioni konstaton se subjekti, deri në DIPP-në e vitit 2009, ka deklaruar në mënyrë periodike kursime *cash*, të cilat janë të mjaftueshme për të paguar këstin e datës 20.2.2010, në shumën 2,000 euro ose 280,000 lekë.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin pasurinë apartament me sip. 85.4 m². Nuk ka dyshime për çmim preferencial apo për favorizim në çmim nga shoqëria ndërtuese. Subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

2. Tokë arë me sip. 5,000 m², e përfituar nga ligji nr. 7501, ndodhur në fshatin *, Lushnjë.** Pjesa takuese si anëtar i familjes bujqësore në bazë të përbërjes familjare të datës 1.8.1991. Vërtetuar nga AMTP-ja nr. *** regjistri, lëshuar në datën 25.5.1993 nga Komisioni i Tokës në fshat. Kjo pasuri nuk është regjistruar në ZVRPP, për shkak se në zonën ku ndodhet nuk ka kaluar ende procesi i menaxhimit të tokave nga kjo zyrë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: përfituar pa kundërshtim sipas ligjit nr. 7501.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

2.1 Në deklaratën periodike para fillimit të detyrës 2003 (në vijim DPDFD), subjekti e ka deklaruar këtë pasuri si vijon: “*Tokë bujqësore, 5 dynym, vlera 1,3 milionë lekë, ndodhur në fshatin ***, Lushnjë, përfituar me ligjin nr. 7501. Të ardhura vjetore 0,15 milion lekë*”.

2.2 Së bashku me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (në vijim AMTP) nr. ***, datë 25.5.1993, ku familjes së shtetasit E. C. në fshatin *** i është dhënë në pronësi gjithsej 25,580 m² tokë e llojit arë, si dhe 250 m² truall. Subjekti ka depozituar edhe një certifikatë familjare lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile (në vijim ZGJC) ***, me datë 12.10.2016,

për gjendjen familjare të datës 1.8.1991, ku subjekti Dritan Caka është në përbërje familjare me prindërit, dy vëllezërit dhe motrën.

2.3 Komisioni ka administruar përgjigjen e ASHK-së Drejtoria Vendore Lushnjë²¹, e cila nuk konfirmon të regjistruar pasuri të paluajtshme në emër të subjektit Dritan Caka.

2.4 Subjekti, me anë të pyetësorit nr. 2, ka shpjeguar se për shkak të vonesës që ka ndodhur në procesin e regjistrimit fillestar sistematik të pasurive të paluajtshme për zonën ku ndodhet kjo sipërfaqe toke, nuk është pajisur ende me certifikatë pronësie dhe nuk ka bërë pjesëtimin ligjor të pjesës së tokës prej 5,000 m², që ka përfituar si person sipas ligjit nr. 7501. Megjithatë, me marrëveshje ndërmjet anëtarëve të familjes, kanë përcaktuar vendndodhjen e pjesës së tij të tokës që kur ka bërë shpërndarjen nga trangu familjar i babait në vitin 2002. Për shkak të angazhimit në detyrën e gjyqtarit nuk është marrë vetë me administrimin e kësaj prone, por ka rënë dakord me të vëllanë që ai të administrojë edhe pjesën e tij të tokës.

2.4.1 Subjekti ka depozituar vërtetimet e lëshuara nga Njësia Administrative ***²², ku vërtetohet se babai i subjektit, z. E. C., ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore deri në vitin 2020, si dhe se z. Dritan Caka ka përfituar tokë bujqësore si person, nga zbatimi i ligjit nr. 7501, një sipërfaqe prej 5,000 m² tokë bujqësore, me nr. AMTP-je ***.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin pasurinë arë me sip. 5,000 m².

3. Automjet tip “Daimler Chrysler B180 CDI”, me targë ***, i vitit 2007, blerë me kontratën e datës 17.12.2012²³, në vlerën 900,000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kursimet familjare të krijuara deri në atë kohë.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

3.1 Subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë automjet në DIPP-në e vitit 2012, blerë në vlerën 900,000 lekë, me burim shumën 500,000 lekë, deklaruar si të pakësuar prej kursimeve të viteve të mëparshme, shtuar 400,000 lekë nga kursimet familjare të vitit 2012.

3.2 Komisioni ka administruar përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor²⁴ (në vijim DPSHTRR), e cila konfirmon automjetin tip “Mercedes-Benz B180”, i vitit 2007, në pronësi të subjektit Dritan Caka, përfituar me kontratën e shitblerjes datë 17.12.2012²⁵, ku shitësi E. D. ia shet subjektit me çmimin 900,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Nga dokumentacioni ka rezultuar se shtetasi E. D. e ka blerë këtë automjet në shtetin gjerman dhe nga dokumenti doganor i datës 27.9.2011 si vlerë referuese e automjetit është pasqyruar vlera 250,000 lekë (pasi nuk ka kontratë/faturë blerjeje në dosjen e automjetit) dhe është paguar taksa doganore

²¹ ASHK Lushnjë, me shkresën nr. *** prot., datë 7.1.2021 dhe nr. *** prot., datë 16.12.2022.

²² Vërtetim nr. ***, datë 27.7.2020 dhe nr. ***, datë 27.7.2020, i Njesisë Administrative ***.

²³ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.12.2012.

²⁴ DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 17.12.2020.

²⁵ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.12.2012.

në vlerën 275,402 lekë. Vlera totale e automjetit ka shkuar 525,402 lekë. Më pas, me kontratën e shitblerjes²⁶ datë 28.3.2017, subjekti Dritan Caka ia shet shtetasit J. M., për çmimin 600,000 lekë.

3.3 Komisioni ka verifikuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi me shtetasin E. D. dhe për këtë qëllim ka administruar përgjigjet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku nuk u konstatua një situatë e tillë. Ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka konfirmuar se shtetasi E. D. ka pasur në gjykim dy çështje pranë kësaj gjykate, por janë gjykuar nga gjyqtarë të tjerë dhe jo nga subjekti i rivlerësimit²⁷.

Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të shumës 900,000 lekë, me të cilën është blerë automjeti.

3.4 Në lidhje me burimin e parë prej 500,000 lekësh, pakësuar nga kursimet e mëparshme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2012 pakësimin e kursimeve *cash* në shumën 500,000 lekë, si burim për blerjen e mjetit.

3.4.1 Komisioni, bazuar në deklaratimet që ka bërë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, kreu analizën e ecurisë së likuiditeteve *cash* ndër vite, shtesave/pakësimeve, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit për të krijuar shumën 500,000, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e mjetit në vitin 2012.

3.4.2 Nga leximi i deklaratave periodike rezulton se gjendja *cash* në datën 31.12.2011 është në shumën 1,500,000 lekë, shumë kjo e mjaftueshme për të përballuar pagesën prej 500,000 lekësh për blerjen e mjetit. Gjithashtu, gjendja *cash* e akumuluar është krijuar me të ardhura të ligjshme, pasi analiza financiare rezulton me balanca pozitive për periudhën deri në vitin 2011.

3.5 Në lidhje me burimin e dytë prej 400,000 lekësh, nga kursimet familjare të vitit 2012, analiza financiare e këtij viti ka rezultuar me burime të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive, ndër të cilat edhe blerja e automjetit tip “Daimler Chrysler” në datën 17.12.2012, për të cilën subjekti ka përdorur 400,000 lekë nga të ardhurat e vitit 2012.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie.

4. Gjendje në llogarinë rrjedhëse të pagës pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën 3,885,682.50 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kursimet në vite prej të ardhurave familjare të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

4.1 “Raiffeisen Bank”²⁸ konfirmon gjendjen e llogarisë së pagës në emër të subjektit, në shumën 3,885,682.50 lekë, në datën 27.1.2017. Nga veprimet bankare rezulton se kjo gjendje në llogari është krijuar nga pagat e subjektit të rivlerësimit, të cilat në pjesën më të madhe nuk janë tërhequr, duke filluar nga qershori i vitit 2014, si dhe një depozitimi *cash* prej 500,000 lekësh në datën 6.11.2015. Kursimet e akumuluar nga pagat e patërhequra të subjektit të rivlerësimit në datën

²⁶ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 28.3.2017.

²⁷ Vendimi nr. ***, datë 17.2.2012, gjykuar nga gjyqtari S. H. dhe vendimi nr. ***, datë 11.9.2012, gjykuar nga gjyqtari A. A.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020.

6.11.2015, në shumën 1,973,763 lekë, janë investuar në bono thesari në vlerën 1,500,000 lekë, investim i cili pas maturimit të tij në datën 10.11.2016 është rikthyer në llogarinë e pagës, duke krijuar gjendjen e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

4.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 investimin në bono thesari, si vijon: *“Depozitë në bono thesari krijuar nga të ardhurat familjare të vitit 2015, në shumën 1,500,000 lekë, me pjesë takuese 100%”*.

4.3 Në lidhje me depozitimin *cash* nga subjekti të shumës 500,000 lekë tek kjo llogari, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të depozitimit prej 500,000 lekësh. Subjekti në përgjigje të tij ka shpjeguar se kjo shumë ka pasur si burim të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes si notere.

4.4 Nga pasqyrat financiare të aktivitetit privat të bashkëshortes rezulton se për vitin 2015 ajo ka tërhequr nga aktiviteti shumën 3,175,629 lekë, e cila është e mjaftueshme për të mbuluar depozitimin në bankë të shumës 500,000 lekë.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin krijimin e kësaj depozite.

5. Gjendje në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes si person fizik (notere), në shumën 1,829,203.19 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të krijuara nga të ardhurat prej aktivitetit si noterë, si profesion i lirë dhe të deklaruara në organet tatimore.

5.1 Nga ABI Bank²⁹ konfirmohet llogaria rrjedhëse në monedhën lekë në emër të personit fizik “****”, me NIPT ***, të hapur në datën 1.4.2014. Në këtë llogari bankare rezulton të jenë kryer veprime në funksion të aktivitetit, por edhe veprime nga persona të tretë për depozitimin/transferimin e shumave për tjetërsim pasurie.

5.2 Nga pasqyrat financiare të deklaruara pranë organeve tatimore, si dhe të depozituara në QKB, rezulton se në fund të vitit 2016 gjendja e kësaj llogarie i përket personit fizik dhe nuk ka të mbartura transaksione për tjetërsim pasurie, pasi në pasqyrën e pozicionit financiar nuk ka të deklaruar “Debitorë të tjerë”.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin krijimin e kësaj llogarie.

6. Gjendje *cash* në shumën 800,000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: krijuar nga kursimet prej të ardhurave familjare të subjektit dhe bashkëshortes.

²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.11.2020.

6.1 Në deklaratat periodike vjetore të viteve 2003 – 2016, subjekti ka deklaruar gjendjen *cash* me shtesa dhe ndryshimet përkatëse³⁰, ndërsa në procesverbalin e datës 25.3.2015, të mbajtur në ILDKPKI³¹, ka deklaruar se gjendja *cash* në fund të vitit 2013 ka qenë 1,000,000 lekë.

6.2 Me pyetësin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë në mënyrë kronologjike krijimin e gjendjes *cash* prej 800,000 lekësh, të deklaruar në deklaratën *Vetting*. Në përgjigje të tij, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar gjendjen *cash* në 31 dhjetor të çdo viti, duke analizuar deklarimin e tij periodik në mënyrë kronologjike deri në krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*, në shumën 800,000 lekë.

6.2.1 Subjekti është ndalur në DIPP-në e vitit 2005, për të shpjeguar pasaktësinë e tij në deklarim. Sikurse ka rezultuar nga deklaratimet periodike, gjendja *cash* e akumuluar deri në datën 31.12.2004 ka qenë në total 1,400,000 lekë. Kjo gjendje është pakësuar në 734.000 lekë në datën 20.1.2005, kur është kryer pagesa e këstit të parë, sipas kontratës së sipërmarrjes prej 666,000 lekësh (5,328 euro) në favor të shoqërisë sipërmarrëse “****” sh.p.k. (1,400,000 lekë – 666,000 lekë = 734,000 lekë). Po gjatë vitit 2005 subjekti ka pasur një pakësim tjetër prej rreth 200,000 lekësh të gjendjes *cash* të akumuluar dhe deklaruar deri në datën 31.12.2004, të cilat janë përdorur për blerjen e disa pajisjeve të nevojshme për mobilimin e apartamentit, sikurse ka shpjeguar edhe në përgjigje të pyetësit nr. 1. Shuma e gjendjes *cash* që zotëronte ka mbetur 534,000 lekë, të cilat janë përdorur për shpenzime të tjera jetese gjatë vitit 2005, së bashku me të ardhurat e tjera të realizuara atë vit. Në këtë mënyrë, në fund të vitit 2005 gjendja *cash* ka qenë shpenzuar totalisht, duke mbetur 0 (zero) lekë.

6.2.2 Për shkak se procesi i deklarimit të pasurive pranë ILDKPKI-së në atë kohë ishte në vitet e para të zbatimit dhe nuk kishte krijuar përvojë në plotësimin e saktë të deklaratave periodike vjetore, në DIPP-në e vitit 2005 nuk ka deklaruar pakësimin total të gjendjes *cash*, që kishte deklaruar në deklaratën e parë të vitit 2003 dhe atë të vitit 2004. Në vazhdim, subjekti ka shpjeguar ndryshimet (shtesat/pakësimet) ndër vite, nga ku sipas tij gjendja e akumuluar deri në datën 31.12.2013 ka qenë në shumën 1,000,000 lekë. Fakti që gjendja *cash* në fund të vitit 2013 ka qenë në shumën 1,000,000 lekë, është deklaruar prej tij edhe në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 25.3.2015. Në përfundim, sipas deklaratimeve periodike në datën 31.12.2016, gjendja *cash* ka qenë 1,300,000 lekë dhe deri në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, pasi një pjesë është përdorur për nevoja familjare, gjendja *cash* në datën 27.1.2017 ka qenë 800,000 lekë³².

³⁰ DIPP/2003 – 0.8 milion – burimi nga paga dhe të ardhurat nga toka bujqësore; DIPP/2004 – 600,000 lekë – nga data 1.1.2004 deri më 31.12.2004; DIPP/2005 – nuk ka deklarim; DIPP/2006 – 450,000 lekë – shtuar nga shitja e automjetit tip “Audi 80”, 100,000 lekë të ardhurat nga përdorimi i sipërfaqes së tokës bujqësore prej 5,000 m²; DIPP/2007 – 100,000 lekë – shumë e krijuar nga produktet e tokës bujqësore të ruajtura në banesë, pasuri e shtuar; DIPP/2008 – 250,000 lekë – shtuar shuma, krijuar nga të ardhurat e produkteve bujqësore të ruajtura në banesë; DIPP/2009 – 300,000 lekë – shtuar shuma, krijuar nga të ardhurat e produkteve bujqësore të ruajtura në banesë; DIPP/2010 – nuk ka deklarim; DIPP/2011 – 300,000 lekë – shtuar shuma *cash* kursime prej totalit të të ardhurave për vitin 2011; DIPP/2012 – 500,000 lekë – pakësuar shuma e të hollave *cash*; DIPP/2013 – nuk ka deklarim; DIPP/2014 – 1,200,000 lekë – shtuar likuiditete gjendje *cash*, të kursyera nga totali i të ardhurave familjare të vitit 2014; DIPP/2015 – nuk ka deklarim; DIPP/2016 – 900,000 lekë – pakësuar totali i gjendjes *cash*, deklaruar deri në vitin 2015.

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2020, e ILDKPKI-së.

³² Për detaje, shihni përgjigjen nr. 3 në pyetësin nr. 2.

6.3 Komisioni vëren se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në pyetësin nr. 2, në lidhje me ndryshimet e gjendjes *cash* ndër vite, janë në përputhje me deklaratimet e tij periodike, me përjashtim të vitit 2005, ku konstatohet mosdeklarimi i pakësimit të gjendjes *cash*. Pavarësisht këtij deklarimi, shpjegimet e dhëna nga subjekti për ndryshimet dhe gjendjen *cash* në fund të çdo viti përputhen edhe me deklarin e tij në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI më 25.3.2015 (para deklaratës *Vetting*), si dhe me gjendjen e deklaruar në deklaratën *Vetting*. Gjithashtu, pasaktësia në deklarin e vitit 2005 nuk shoqërohet me mungesë burimesh të ligjshme për vitin 2005 e për rrjedhojë ajo vlerësohet me peshë të papërfillshme në lidhje me rezultatin përfundimtar mbi rivlerësimin e subjektit për kriterin e pasurisë.

6.3.1 Gjithashtu, Komisioni vëren se subjekti ka deklaruar në vitin 2003 vlerën e kursimeve *cash* prej 800,000 lekësh, me burim nga paga dhe të ardhurat nga toka bujqësore, të cilat janë trajtuar në analizën financiare të Komisionit vetëm me burim të ardhurat nga paga e tij, pasi gjatë procesit të rivlerësimit nuk u arrit të provohej masa reale e të ardhurave nga produktet bujqësore të përfituara prej tij ndër vite, që kanë ndikuar në krijimin e shumës 800,000 lekë. Ndërsa analiza e burimit të gjendjeve të kursimeve *cash* në vitet 2004 – 2016 është trajtuar në analizën financiare gjithëpërfshirëse të hartuar nga Komisioni.

Të ardhura në formën e ndihmave ushqimore në vite prej produkteve të tokës arë të përfituar në pronësi nga ligji nr. 7501, në shumën 1,630,000 lekë

6.4 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike të ardhurat të përfituara nga shfrytëzimi i tokës/shitja e produkteve bujqësore të tokës me sip. 5, 000 m², të përfituara me ligjin nr. 7501, si vijon:

Tabela nr. 1

Deklarata periodike	Shuma e deklaruar	Përshkrimi
2003	0.15 milion	Të ardhura vjetore
2004	80,000 lekë	Të ardhura nga shfrytëzimi i tokës bujqësore
2006	100,000 lekë	Të ardhura nga shfrytëzimi i tokës bujqësore
2007	100,000 lekë	Krijuar nga të ardhurat e produkteve bujqësore
2008	250,000 lekë	Krijuar nga të ardhurat e produkteve bujqësore
2009	300,000 lekë	Krijuar nga shitja e produkteve të tokës
2010	300,000 lekë	Nga shfrytëzimi sipas destinacionit të vet të tokës bujqësore
2011	300,000 lekë	Të ardhura nga produktet e tokës bujqësore
2012	300,000 lekë	Të ardhura prej tokës

6.5 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në pyetësin standard se për të ardhurat në shumën 1,630,000 lekë nga toka bujqësore, përfituar nga ligji nr. 7501, janë paguar tatimet mbi tokën bujqësore në emër të kryetarit të familjes, babait të tij E. C. (përfaqësuesi i familjes bujqësore). Për këto të ardhura nuk janë paguar detyrime të tjera tatimore, pasi legjislacioni tatimor nuk

parashikonte dhe as nuk parashikon detyrimin për të plotësuar formularët DIVA dhe as pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga produktet e tokës bujqësore.

6.5.1 Për pretendimet e mësipërme, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues: (i) vërtetimin nr. *** prot., datë 27.7.2020, të lëshuar nga zyra e tatim-taksave, Njësia Administrative ***, Bashkia Lushnjë, ku vërtetohet se shtetasi E. C., banor i kësaj njësie, fshati ***, ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore deri në vitin 2020; (ii) vërtetim nr. *** prot., datë 27.7.2020, nga zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, Njësia Administrative ***, Bashkia Lushnjë, ku vërtetohet se z. Dritan Caka ka përfitur tokë bujqësore si person nga zbatimi i ligjit nr. 7501, në zonën kadastrale në juridiksionin e kësaj njësie, një sipërfaqe 5,000 m², me AMTP-në nr. ***.

6.6 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur në ILDKPKI³³ me procesverbalin e datës 25.3.2015, se si i vërteton të ardhurat e deklaruara nga produktet bujqësore në deklaratat periodike të viteve 2008 – 2013, ka shpjeguar se ka deklaruar herë të ardhura dhe herë produkte, pasi realisht ka pasur ndihma ushqimore, edhe për faktin se vëllai administron tokën në fshat.

6.7 Komisioni vëren se subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhura në shumën 1,630,000 lekë, në formën e ndihmave ushqimore prej produkteve të tokës arë, të përfitur në pronësi nga ligji nr. 7501. Në deklaratat periodike të viteve 2003 dhe 2006 – 2009 ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore në formën e likuiditeteve *cash*. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 25.3.2015, kur i është kërkuar të vërtetojë të ardhurat e deklaruara ndër vite (2004 – 2012) nga toka bujqësore, ka shpjeguar se herë ka deklaruar të ardhura dhe herë produkte, pra realisht ka pasur ndihma ushqimore, edhe për faktin se vëllai administron tokën në fshat.

6.8 Me pyetësin nr. 2, Komisioni i kërkoj subjektit të shpjegojë deklaratat periodike në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore në formën e likuiditeteve, si i ka përfitur këto të ardhura dhe të provojë me dokumentacion ligjor deklaratën *Vetting*.

6.8.1 Në përgjigje të pyetësit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se i qëndron deklaratës që ka bërë në deklaratën *Vetting* në lidhje me të ardhurat në formën e ndihmave ushqimore prej produkteve të tokës, që ka përfitur me ligjin nr. 7501. Ky deklaratë përputhet gjithashtu edhe me sa ka shpjeguar në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 25.3.2015, ku ka theksuar se realisht ka pasur ndihma ushqimore nga produktet e tokës bujqësore, të cilën e administron i vëllai. Subjekti sqaron se nuk merret vetë me administrimin e tokës, pasi është vëllai i tij A. C. (i cili është edhe i regjistruar në organet përkatëse shtetërore si fermer) ai që administron edhe pjesën e tokës që subjekti ka përfitur nga ligji nr. 7501. Nga produktet që merr prej tokës vëllai i ka dhënë herë pas here pjesë të tyre, që e kanë ndihmuar të kursejë nga të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes vlerën që do të nevojitej për t'i blerë këto asortimente të nevojshme për ushqimin e familjes. Pra, kur subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore (*cash*) në deklaratat periodike vjetore të viteve 2003 dhe 2006 – 2009 ka pasur parasysh faktin se kanë qenë pikërisht ndihmat ushqimore të përfituara nga ky shfrytëzim i kësaj sipërfaqe toke ato që i kanë dhënë mundësinë që të kursejë

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2020, e ILDKPKI-së.

shumat e deklaruara prej të ardhurave nga paga e tij dhe e bashkëshortes (për periudhën pas lidhjes së martesës).

6.8.2 Subjekti ka depozituar vërtetimin nr. ***, datë 27.7.2020, lëshuar nga Njësia Administrative ***, ku vërtetohet se shtetasi E. C. ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore deri në vitin 2020, si dhe vërtetimin nr. ***, datë 27.7.2020, lëshuar po nga kjo njësi, ku vërtetohet se z. Dritan Caka ka përfituar tokë bujqësore, si person nga zbatimi i ligjit nr. 7501, një sipërfaqe prej 5,000 m² tokë bujqësore, me AMTP-në nr. **. Gjithashtu ka depozituar edhe kartën e fermerit në emër të vëllait A. C.

6.9 Komisioni vlerëson se të ardhurat nga produktet bujqësore të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit janë në nivel deklarativ dhe masa (vlera) e tyre e përfituar prej tij mbetet e paprovuar me dokumentacion justifikues. Për këtë arsye, trupi gjykues nuk përfshiu në analizën financiare të ardhura nga toka bujqësore, por çmon se duke qenë se gjatë procesit të rivlerësimit u konfirmua nga institucionet e ngarkuara me ligj aktiviteti bujqësor i vëllait të tij, pronësia e tokës bujqësore nga babai dhe shlyerja e detyrimeve tatimore (taksa vendore etj.) në analizën financiare të subjektit për periudhën 1998 – 2012, me përjashtim të vitit 2005, shpenzimet jetike duhen reduktuar në masën 47.6 % (sipas INSTAT-it).

Komisioni, bazuar në deklaratimet periodike të subjektit të rivlerësimit, deklaratimet në ILDKPKI dhe ato në pyetësorë, i mori në konsideratë ato dhe nuk konstatoi problematika për sa i përket deklaratimit të gjendjes *cash* ndër vite, si dhe deklaratimit të të ardhurave në formën e produkteve bujqësore.

7. Të ardhurat nga fitimet neto prej aktivitetit të bashkëshortes së subjektit si notere, në profesion të lirë, për periudhën qershor 2013 – dhjetor 2016, sikurse rezulton nga bilancet e dorëzuara në organet tatimore për secilin vit në shumën 12,227,932 lekë.

7.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP të ardhurat neto të përfituara nga aktiviteti i bashkëshortes si notere, si vijon: DIPP/2013 = 781,279 lekë; DIPP/2014 = 3,175,629 lekë; DIPP/2015 = 4,789,029 lekë; DIPP/2016 = 3,481,995 lekë.

7.2 Qendra Kombëtare e Biznesit (në vijim QKB)³⁴ konfirmon regjistrimin e O. D. si person fizik “noter”, me NUIS ***, me datë 9.7.2013.

7.3 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (në vijim DPT)³⁵ konfirmon subjektin “O. D.”, me NIPT ***, me status aktiv që në datën 9.7.2013. Kjo drejtori ka depozituar kopje të deklaratave të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014 – 2019.

7.4 Në dosjen *Vetting* dhe në pyetësorin standard, subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion ligjor në lidhje me aktivitetin privat të bashkëshortes për vitet 2013 – 2016, konkretisht: (i) kopje të formularit të deklaratimit dhe pagesë të tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitin

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 14.12.2020, e QKB-së.

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2020, e DPT-së.

2013, si dhe pasqyrat financiare; (ii) kopje të formularit të deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014 – 2016 dhe pasqyrat financiare për secilin vit.

7.5 Pasqyrat financiare të depozituara nga subjekti i rivlerësimit janë të depozituara edhe në faqen e internetit në QKB. Sipas dokumentacionit financiar rezulton se fitimi neto, pas zbritjes së shpenzimeve për tatimin, është si vijon: viti 2013 – fitimi neto = 781,279 lekë; viti 2014 – fitimi neto = 3,175,629 lekë; viti 2015 – fitimi neto = 4,429,852 lekë; viti 2016 – fitimi neto = 3,481,995 lekë.

7.6 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të saktë në DIPP-të përkatëse fitimin neto të realizuar nga aktiviteti privat i personit fizik, me përjashtim të vitit 2015 kur subjekti i është referuar vlerës së fitimit bruto (para zbritjes së tatimit). Në këto rrethana, Komisioni ka pasqyruar si të ardhura nga aktiviteti privat në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të shumtat e fitimit bruto për periudhën 2013 – 2016, të konfirmuara nga DPT-ja³⁶, si dhe ka pasqyruar si shpenzime pagesat për tatim-fitimin³⁷ të kryera në vitet përkatëse.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes si notere.

KONSTATIME TË TJERA

8. Në lidhje me automjetin tip “Audi 80”, i vitit 1989, me targë *, blerë në vlerën 0,35 milion lekë (ose 350,000 lekë)**

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

8.1 Ky automjet është deklaruar në DPFDD-në e vitit 2003³⁸ me vlerë 0,35 milion/lekë, blerë me të ardhurat nga paga, ndërsa në DIPP-në e vitit 2006 subjekti ka deklaruar shitjen e tij në çmimin 450,000 lekë.

8.2 DPSHTRR-ja³⁹ ka konfirmuar se automjeti tip “Audi 80” ka qenë në pronësi të subjektit Dritan Caka dhe më pas i është shitur shtetasit B. T. me kontratën e datës 7.3.2006⁴⁰, me çmimin 450,000 lekë. Nga dokumentacioni i depozituar pranë Komisionit konstatohet se subjekti Dritan Caka e ka blerë këtë mjet me kontratën e datës 21.3.2003⁴¹ nga shtetasi A. J., me çmimin 200,000 lekë, ndërkohë që nga ky i fundit është paguar edhe taksa doganore, me datë 20.3.2003, në vlerën 158,528 lekë. Në dosje nuk ndodhet dokumenti (kontrata/fatura) se sa është blerë ky automjet në shtetin italian nga shtetasi A. J..

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 14.12.2020.

³⁷ Tatim-fitimi i paguar = detyrime për tatim-fitimin në fillim të vitit + shpenzime tatime të llogaritura për vitin – detyrime për tatim-fitimin në fund të vitit. Të dhënat për detyrimet për tatim-fitimin në fillim të vitit, shpenzim-tatimin e llogaritur dhe detyrimet për tatimin në fund të vitit janë pasqyruar në pasqyrat financiare të shoqërisë të depozituara në QKB.

³⁸ *Autoveturë Audi 80, i vitit 1989, me targë ***, me vlerë 0,35 milion/lekë, pjesa takuese 100%, me burim: blerë me të ardhurat nga paga.*

³⁹ Përgjigje nr. *** prot., datë 14.12.2022, e DPSHTRR-së.

⁴⁰ Kontratë shitjeje nr. ***, datë 7.3.2006.

⁴¹ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.3.2003.

8.3 Për sa i përket analizimit të burimit për blerjen e kësaj pasurie, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1998 – 21.3.2003, duke konsideruar: (i) të ardhurat nga pagat e subjektit; (ii) shpenzimet e jetesës; (iii) blerjen e automjetit, nga ku rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit në datën 21.3.2003⁴².

8.4 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se ka mospërputhje deklarimi nga ana e subjektit, për sa i përket çmimit të blerjes së automjetit, deklaruar në DPFĐ-në e 2003 në vlerën 0,35 milion lekë, me kontratën e shitblerjes të vitit 2003, që pasqyron çmimin 200,000 lekë. Gjithashtu, konstatohet se shitja e automjetit tip “Audi 80”, në vlerën 450,000 lekë, pas 3 vitesh përdorimi me më shumë se dyfishin e vlerës së blerjes, përbën veprim financiar të pajustificuar dhe, për këtë qëllim, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare si të ardhur vetëm vlerën 200,000 lekë. Për këto konstatime, subjekti të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

8.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet dhe gjatë seancës dëgjimore, ka dhënë të njëjtat shpjegime. Për mospërputhjen e vlerës së blerjes së automjetit tip “Audi 80”, ka shpjeguar se ai ka deklaruar në DPFĐ-në e vitit 2003 vlerën që mendohej se kishte në treg ky automjet, pa iu referuar kontratës së shitblerjes së tij. Ndërsa për shitjen e tij me vlerë më shumë se dyfishi i blerjes pas 3 vitesh përdorimi, subjekti ka shpjeguar se këtë automjet e kishte blerë me defekt dhe pas riparimit e blerjes së pjesëve të tjera të këmbimit i është rritur edhe vlera e shitjes. Subjekti shprehet se është dakord me pasaktësinë e konstatuar nga Komisioni.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

8.6 Komisioni vëren se për mospërputhjen e vlerës së blerjes, deklaruar prej tij në DPFĐ-në e vitit 2003, subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme, duke e sqaruar këtë pasaktësi në deklarim, e cila nuk ka peshë specifike që mund të ndikojë negativisht në vlerësimin e subjektit, për sa i përket kriterit të pasurisë, duke bërë që ai të mos ndodhet në kushtet e shkronjës “a” të pikës 5 të ligjit nr. 84/2016, lidhur edhe me faktin që kjo është pasuri që nuk vjen në *Vetting*.

8.7 Për sa i përket shitjes së automjetit me më shumë se dyfishin e çmimit, shpjegimi i tij është deklarativ dhe i pambështetur në prova dhe Komisioni ka përfshirë në analizë financiare si të ardhur vetëm vlerën e blerjes sipas kontratës në shumën 200,000 lekë. Përfshirja e shumës 200,000 lekë në analizë financiare nuk ndikon në këtë analizë, pasi subjekti, ashtu siç është thënë edhe më lart, ka rezultuar me balancë pozitive për blerjen e këtij automjeti.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë të çmimit të blerjes së këtij automjeti në vitin 2003, çka vlerësohet me një peshë të papërfillshme në lidhje me vlerësimin e pasurisë dhe atë tërësor për këtë subjekt rivlerësimi. Subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e tij.

⁴² Periudha 1998 – 21.3.2003; të ardhura = 1,630,245 lekë, të ardhurat nga paga e subjektit = 1,630,245 lekë, detyrime = 0 (zero), shpenzime = 691,195 lekë, shpenzime jetike = 491,195 lekë, shpenzime mobilimi = 200,000 lekë, pasuri = 200,000 lekë, automjet Audi 80, blerë më 21.3.2003 = 200,000 lekë, të ardhura + detyrime – shpenzime – pasuri = 439,051 lekë.

9. Në lidhje me kontratën e energjisë elektrike për abonentin Dritan Caka në instancën Kavajë, me datë hapjeje 18.11.2004

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

9.1 Komisioni ka administruar përgjigjen e FSHU-së⁴³, e cila konfirmon abonentin Dritan E. C. me kontratë nr. ***, me adresë instanca Kavajë dhe datë hapjeje kontrate 18.11.2004.

9.2 Është administruar përgjigjja e ASHK Drejtoria Vendore Kavajë⁴⁴, e cila nuk konfirmon të regjistruara apo të tjetërsuara pasuri të paluajtshme në pronësi të subjektit Dritan Caka dhe personave të lidhur me të në instancën Kavajë.

9.3 Komisioni ka vijuar hetimin, duke administruar përgjigjet e pyetësorit standard të depozituar nga subjekti, i cili ka shpjeguar se në vitin 2018 ai dhe bashkëshortja O. D. kanë blerë një apartament me sip. 72 m² të ndodhur në fshatin ***, i regjistruar në ZVRPP-në Kavajë. Kjo pasuri është blerë kundrejt çmimit 3,700,000 lekë, i cili është paguar nga kursimet e deklaruara në llogarinë rrjedhëse të pagës në “Raiffeisen Bank” të subjektit Dritan Caka për vitet paraardhëse. Pagesa është kryer me transfertë bankare nga llogaria e deklaruesit në llogarinë e palës shitëse.

9.3.1 Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti në këtë pyetësor, rezulton se ky apartament është përfituar prej tij me kontratën e datës 20.3.2018⁴⁵, ku shtetasja S. A. i shet subjektit Dritan Caka dhe bashkëshortes së tij O. D. apartamentin me sip. 72 m², me adresë ***, Kavajë, për çmimin 3,700,000 lekë, likuidimi i të cilit është bërë me transfertë bankare. Pronësia e këtij apartamenti në emër të palës shitëse S. A. vërtetohet nga certifikata për vërtetim pronësie me datë 12.12.2017, e lëshuar nga ZVRPP-ja Kavajë.

9.3.2 “Raiffeisen Bank⁴⁶” konfirmon veprimin bankar të kalimit të shumës 3,700,000 lekë nga llogaria e pagës së subjektit të rivlerësimit në datën 20.3.2018, në llogarinë e personit fizik “E. K.” (notere).

9.4 Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të shumës 3,700,000 lekë, Komisioni vëren se burimi i deklaruar nga subjekti “kursimet e deklaruara në llogarinë rrjedhëse të pagës në “Raiffeisen Bank” të subjektit” është i saktë, pasi në datën e transferimit të shumës 3,700,000 lekë ka pasur në llogarinë e tij në gjendje shumën 5,247,130 lekë.

9.5 Komisioni, nisur nga fakti se kontrata me FSHU-në rezulton në emrin e z. Dritan Caka në instancën Kavajë, me datë hapjeje nëntor 2004, ndërkohë që subjekti ka depozituar kontratë shitblerjeje apartamenti të vitit 2018, me qëllim për të hequr çdo dyshim në lidhje me këtë pasuri, i ka kërkuar subjektit të provojë dhe dokumentojë se cili është personi që ka lidhur kontratë me FSHU-në në vitin 2004, si dhe të depozitojë dokumentacionin ligjor të ndryshimit të kontratës nga

⁴³ Përgjigje nr. *** prot., datë 21.11.2022, e FSHU-së.

⁴⁴ Përgjigje nr. *** prot., datë 12.12.2022, e ASHK Drejtoria Vendore Kavajë.

⁴⁵ Kontratë e shitblerjes nr. ***, datë 20.3.2018.

⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020.

pronari i mëparshëm tek subjekti. Për këtë konstatim subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

9.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, dha të njëjtat shpjegime. Ai shpjegoi se Komisionit nuk i është dërguar i plotë dokumentacioni përkatës nga ana e FSHU-së. Kontrata e datës 18.11.2004 nuk është hapur prej tij, por kalimi i kësaj kontrate në emrin e tij është bërë pas datës 20.3.2018, kur prej subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes është blerë apartamenti në fjalë me kontratën e datës 20.3.2018 nga shtetasja S. A.. Nga sa ka marrë dijeni për këtë pallat ku ndodhet apartamenti, ka pasur probleme dokumentacioni, pasi edhe pala shitëse S. A. e ka regjistruar apartamentin në vitin 2017. Kjo e fundit ka vënë në dispozicion të subjektit librezat e pagimit të energjisë elektrike dhe ka rezultuar se në këto librezat figuronte emri i shtetasit S. M. dhe jo i shtetasës S. A. Emri i këtij personi në librezat e energjisë elektrike ka rezultuar nga fakti se këta dy shtetas kanë pasur marrëdhënie kontraktore me njëri-tjetrin dhe kontrata me datë 18.11.2004 është hapur nga shtetasi S. M. dhe nuk është ndryshuar në emër të shtetasës S. A. Ky fakt e ka penguar subjektin e rivlerësimit për disa muaj pas blerjes së apartamentit që të ndryshojë edhe kontratën e furnizimit me energji elektrike e, për këtë, subjekti ka vijuar deri vonë të paguajë faturat në emrin e shtetasit S. M.. Pas aplikimit për ndryshimin e kontratës nga shtetasi S. M. tek subjekti, është bërë ndryshimi i kontratës me datë 16.11.2019.

9.6.1 Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të prapësimeve të dhëna, ka depozituar në cilësinë e provës formularin për ndryshimin e kontratës së datës 16.11.2019 nga shtetasi S. M. tek z. Dritan Caka. Është depozituar gjithashtu librezat e pagimit të energjisë elektrike të instancës Kavajë, me adresë ***, librezat në emër të z. S. M. për pagesa të energjisë elektrike 2015 – 2022. Gjithashtu, ka depozituar fatura të OSHEE-së të muajit janar 2007, të viteve 2018 dhe 2019 për kontratën me nr. *** në emër të shtetasit S. M. dhe, më pas, faturat e muajit dhjetor 2019 e në vijim për kontratën me nr. *** janë lëshuar në emër të subjektit Dritan Caka.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

9.7 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse. Bazuar në shpjegimet e tij dhe provat e depozituara, provohet se kontrata me nr. ***, me datë hapjeje 18.11.2004, nuk është kontratë e çelur nga subjekti i rivlerësimit. Nga dokumentacioni i depozituar provohet se faturat për të njëjtën kontratë që në fillim janë printuar me emrin e shtetasit S. M., që duket se ka qenë personi i cili e ka pasur i pari në pronësi këtë apartament dhe që më pas është tjetërsuar nga shtetasja S. A. Bazuar në shpjegimet e subjektit për shkak të problemeve në dokumentacion, nuk është bërë ndryshimi i kësaj kontrate në emër të shtetasës S. A., fakt ky i provuar me certifikatën për vërtetim pronësie të vitit 2017, që është lëshuar për këtë shtetase. Pasi subjekti e ka blerë këtë apartament nga kjo e fundit në vitin 2018, ka vijuar procedurat e ndryshimit të emrit të kontratës nga personi i cili e kishte lidhur i pari kontratën me OSHEE-në, z. S. M., ndryshim i cili u bë i mundur në vitin 2019. Llogaria bankare nga e cila është bërë pagesa e çmimit të blerjes së apartamentit, është llogaria e pagës së subjektit, e furnizuar në vazhdimësi me të

ardhurat nga punësimi i subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, nuk konstatohen problematika në lidhje me të.

Komisioni vëren se nuk konstaton problematika në lidhje me përfitimin e kësaj pasurie, si dhe me burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

10. Analiza financiare

10.1 Komisioni, pasi analizoi deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë dhe atë *Vetting* për periudhën e hetimit 2000 – 2016, të kryer prej tij, konkludoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën -1,287,574 lekë për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë. Subjekti ka rezultuar me balancë negative për vitin 2014, pasi të ardhurat në dispozicion në vitet përkatëse kanë qenë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet dhe krijimin e pasurive. Për konstatimin e mësipërm subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

10.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se rezultati negativ i konstatuar në analizën financiare të vitit 2014 nuk qëndron, pasi nga vlerësimi real i treguesve financiarë si subjekt rivlerësimi dhe atyre të bashkëshortes si person i lidhur, vërtetojnë se kanë pasur të ardhura më se të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë e deklaruar si të shtuar në DIPP-në e vitit 2014.

10.3 Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se nga detajet e tabelës përmbledhëse të analizës financiare rezulton se krahas të dhënave të deklaruara në DIPP-në e vitit 2014 është përfshirë në zërin e shpenzimeve edhe vlera e “gjendjes arka”, e shënuar në pasqyrat financiare (bilancin) të bashkëshortes O. D. si person fizik. Ai ka shpjeguar se nuk i ka konsideruar vlerat monetare të zërit “arka” si likuiditet në pasqyrat financiare të aktivitetit që ushtron bashkëshortja si person fizik as në DIPP dhe as në deklaratën *Vetting*, sepse kjo gjendje likuiditeti nuk ka ekzistuar ndonjëherë realisht jo vetëm për vitin 2014, por as për vitet e tjera para apo pas tij, gjatë veprimtarisë së bashkëshortes si notere. Pasqyrimi i shumës së likuiditetit në fjalë në zërin “arka” të pasqyrave financiare të bashkëshortes si person fizik ka ardhur vetëm si pasojë e një gabimi të bërë nga përpiluesi i këtyre pasqyrave në lidhje me zbatimin e legjislacionit fiskal të kohës, ndërkohë që e vërteta është se gjendja e likuiditetit në këtë zë nuk ka ekzistuar si në përfundim të vitit 2014, ashtu edhe në përfundim të vitit financiar të periudhës së hetimit administrativ. Duke qenë se aktiviteti tregtar që ushtron bashkëshortja O. D. është regjistruar në QKB dhe në DRT-më Tiranë si person fizik, me përgjegjësinë tatimore të llojit “Biznes i vogël”, ajo nuk ka pasur dhe nuk ka detyrimin që të deklarojë “fluksin monetar” dhe as të shpjegojë për organin tatimor “destinimin” e të ardhurave neto që realizon nga biznesi i saj, nuk merr “pagë” për punën që kryen dhe njëkohësisht nuk ka detyrimin për të shpërndarë “dividend”. Ndërkohë, në bilancin e dorëzuar në DPT janë pasqyruar rregullisht vlera e të ardhurave, vlera e shpenzimeve, si dhe fitimi i personit fizik, mbi të cilat janë kryer edhe pagesat përkatëse për tatimin e thjeshtuar.

10.4 Subjekti e ka deklaruar rregullisht vlerën e fitimit nga të ardhurat e aktivitetit të noterisë në DIPP dhe në deklaratën *Vetting*, pasi në fakt kjo vlerë fitimi është tërhequr dhe përdorur gjatë vitit nga bashkëshortja e tij për nevojat familjare dhe mbulimin e shpenzimeve të ndryshme, përfshirë ato për krijimin e likuiditetit *cash* të deklaruar si shtesë në DIPP, gjë e cila është sqaruar edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2. Me sa është shpjeguar nga përpiluesi i pasqyrave financiare, nga ana e tij është përdorur kjo metodë deklarimi për zërin “arka” të bilancit për shkak të legjislacionit fiskal në fuqi gjatë periudhës 2013 – 2016, i cili ka pasur paqartësi në lidhje me destinimin e të ardhurave nga biznesi i vogël. Për këtë shkak, vlerat e tërhequra gjatë vitit nga administratori i personit fizik përpiluesit e pasqyrave financiare i vendosin formalisht në bilanc nën zërin “gjendje arka”, madje duke e rritur artificialisht gjendjen e saj nga njëri vit në tjetrin, sepse gjendja e arkës në përfundim të çdo viti financiar mbartej për vitin pasardhës. Kjo metodikë e përdorur prej përpiluesit të pasqyrave financiare shpjegon edhe shumën prej 3,504,519 lekësh të shënuar si “gjendje arka” të datës 31.12.2014 në pasqyrat financiare të aktivitetit të bashkëshortes si person fizik, shumë e cila në mënyrë krejt alogjike rezulton të jetë më e lartë sesa i gjithë fitimi neto për vitin 2014, i cili ka qenë në vlerën 3,175,629 lekë.

10.5 Pra, në të vërtetë, “gjendja e arkës” e shënuar në mënyrë të gabuar në pasqyrat financiare të vitit 2014 rezulton se korrespondon me fitimin neto prej aktivitetit të bashkëshortes si person fizik për vitet 2013 dhe 2014 të marra së bashku. Për sa ka shpjeguar, subjekti i kërkon Komisionit që të mos marrë në konsideratë vlerën monetare “gjendje arka” të vendosur në tabelën financiare që llogarit rezultatin financiar të vitit 2014 për aktivitetin e bashkëshortes si person fizik notere. Nëse ky shpjegim do të merret në konsideratë, rezultati financiar i vitit 2014 jo vetëm që nuk do të jetë negativ, siç pasqyrohet në dokumentin “Relacion mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ”, por do të rezultojë në vlera tërësisht pozitive⁴⁷. Subjekti gjithashtu ka referuar edhe një praktikë të Kolegjit, konkretisht vendimin nr. 31, datë 12.10.2021, që referon një situatë plotësisht analoge me të subjektit të rivlerësimit në lidhje me gjendjen e arkës së personit fizik notere.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

10.6 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me balancën negative -1,287,574 lekë, e cila krijohet në vitet 2013 – 2014, për shkak të mospërfshirjes së të ardhurave nga aktiviteti i personit fizik të bashkëshortes (noteri). Gjatë hetimit administrativ u provua se për vitin 2014 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti i saj noteri ka përfituar të ardhura të ligjshme në shumën neto 3,175,629 lekë, të ardhura këto të konfirmuara dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në përgjigjen që kjo e fundit i ka dërguar Komisionit. Këto janë konsideruar nga Komisioni të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasi vijnë nga burime të ligjshme, por nga leximi i pasqyrave financiare të personit fizik “O. D.” (notere) në dukje këto të ardhura ishin tek “arka” dhe nuk ishin përdorur nga subjekti i rivlerësimit për të krijuar gjendjen *cash* të deklaruar.

⁴⁷ Për detaje referojuni prapësimeve të subjektit të depozituara në dosje.

10.7 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, argumentoi se pasqyrimi i gjendjes “arka” ishte gabim i personit që ka plotësuar pasqyrat financiare, pasi realisht ajo gjendje nuk ka ekzistuar, pasi të ardhurat janë tërhequr për t’u përdorur për nevoja familjare, duke iu referuar praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁴⁸ (në vijim Kolegji), i cili trajtonte një situatë të ngjashme me atë të subjektit të rivlerësimit Dritan Caka. Komisioni, pasi u thellua në rastin e Kolegjit, i cili trajtonte një situatë të ngjashme, vlerësoi në analogji me rastin e subjektit të rivlerësimit Dritan Caka argumentet e Kolegjit, ku ndër të tjera analizonte se subjektet kanë detyrimin të deklarojnë dhe provojnë të ardhurat e tyre të ligjshme, sipas përcaktimit të pikës 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, të ardhura të cilat vlerësohet nëse arrijnë të mbulojnë pasuritë e krijuara prej subjekteve, si dhe shpenzimet e kryera prej tyre në funksion të rivlerësimit të kriterit të pasurisë. Kolegji e konsideron të pambështetur në fakte dhe në ligj qëndrimin e Komisionit, që ka konsideruar si pasuri të njësisë familjare edhe “gjendjen arka”, që figuron e deklaruar në bilancet e personit fizik që zotërohet nga personat e lidhur. Kolegji arriti në konkluzionin se pretendimi i subjektit për mosekzistencën reale të gjendjes “arka”, sipas deklarimeve në pasqyra financiare, është i besueshëm dhe, për pasojë, njësia familjare nuk mund të ngarkohet me këtë shpenzim në vitet kur ai është pasqyruar si i tillë.

10.8 Komisioni, duke vlerësuar tërësinë e rrethanave, shpjegimet e subjektit, provat e administruara gjatë hetimit administrativ dhe praktikën e konsoliduar të Kolegjit, çmoi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave të përfituara nga aktiviteti i bashkëshortes së subjektit si notere, pasi rezultoi se u provua realizimi i këtyre të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortes si person fizik. Gjithashtu rezultoi se për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore pranë organeve tatimore dhe, të konfirmuara prej tyre, këto të ardhura janë deklaruar në deklaratat periodike, si dhe në atë *Vetting* sipas ligjit nr. 84/2016, Komisioni vendosi t’i përfshijë ato në vlerën 1,200,000 lekë për vitin 2014, duke mos e konsideruar gjendjen “arka” të pasqyrave financiare. Pasi Komisioni i përfshiu këto të ardhura, rezultati financiar përfundimtar i analizës financiare ishte me një vlerë negative prej -56,393 lekësh, vlerë kjo e cila konsiderohet me një peshë të papërfillshme për t’u marrë në konsideratë si element penalizues për subjektin e rivlerësimit në aplikimin e ndonjë mase disiplinore ndaj tij.

⁴⁸ Vendim nr. 31, datë 12.10.2021, i Kolegjit për subjektin G. B.

Analiza financiare 2003 – 2016

Periudha	1998-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	1,000,000	600,000	1,872,328	530,884	129,921	176,154	257,050	280,726	311,324	405,315	-8,056	1,999,271	1,795,352	306,809
Tokës bujqësore 5 dyçmym 100 %, fshati M*, K*, L*														
Autoveturë tip A* v.v. 1989, targa TR*	200,000													
Apartament banor në T*, R., T*B*, sip. 85.4 m2, k.2			3,165,360					280,000						
Autoveturë e përdorur tip B*, model B*, v.p. 2007										900,000				
Ndërveshmë Likuiditeti (L.k.në fund-L.k.në fillim)	800,000	600,000	-1,293,032	530,884	129,921	176,154	257,050	726	311,324	-494,685	-8,056	1,999,271	1,795,352	306,809
Likuiditet në fillim të vitit	800,000	1,400,000	106,968	637,832	767,775	943,927	1,200,978	1,201,704	1,313,027	1,018,342	1,010,286	3,009,558	4,804,910	5,111,719
Likuiditet në fund të vitit	800,000	1,400,000	106,968	637,832	767,775	943,927	1,200,978	1,201,704	1,313,027	1,018,342	1,010,286	3,009,558	4,804,910	5,111,719
DETYRIME	0	0	2,740,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kredi T* B* 14.4.2005			2,500,000											
Dejtyrim ndaj shoqërisë "S*" shpk			240,000											
Debitorë të tjerë														
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	1,000,000	600,000	-867,672	530,884	129,921	176,154	257,050	280,726	311,324	405,315	-8,056	1,999,271	1,795,352	306,809
TE ARDHURA dokumentuar	2,104,029	788,223	843,953	1,351,077	1,005,435	1,391,453	1,705,371	1,724,966	1,790,933	1,816,622	1,602,608	2,156,997	4,515,259	5,675,021
Të ardhura nga para (bursa) në Manjistraturë 1998-2000 + Elapart T	441,810								36,000	36,000				
Të ardhura nga paga dhe shpërblymjet si gjuqtar në stazh Gj.D*	437,804													
Të ardhura nga para e subjektit Gj. L*	1,224,415	788,223	843,953	993,953	916,098	898,932	955,815	940,346	999,040	999,737	1,007,017	0	0	0
Të ardhura nga para e subjektit Gj. T*											29,921	1,263,518	1,192,437	1,228,169
Të ardhura nga KLD									36,000	108,000	135,000	112,200	102,000	17,000
Të ardhura nga paga e b/s/h						492,521	749,556	784,620	387,315	480,136	430,670			
Të ardhura të b/s/h nga leja e fundit paguar DRSSH L* 2006-2007				157,124	89,337									
Të ardhura të b/s/h nga leja e fundit paguar DRSSH T* 2011-2012									327,578	192,749				
Të ardhura nga aktiviteti i noterisë sipas tërheqjeve të fitimit											0	781,279	3,175,629	4,429,852
Të ardhura nga toka bujqësore														
Të ardhura nga interesat bankare													45,193	
Të ardhura nga shërbimet			200,000						5,000					
Bonus Debe														
SHPENZIME	560,925	185,229	490,162	640,114	830,025	693,582	934,272	1,011,142	1,034,828	721,019	1,641,153	1,383,630	1,419,105	1,568,849
Shpenzime jetike	295,925	49,185	57,408	114,029	370,942	214,767	214,767	214,767	249,875	295,586	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi	76,044	0	0	133,536	129,339	41,151	0	48,405	62,874	217,326	353,638	322,001	351,702	
Shpenzime kredie (kasti +sigurime)			212,754	276,084	305,528	349,476	578,355	696,376	636,545	262,539	709,731			
Shpenzime mobili	200,000	200,000	250,000				100,000	100,000	100,000	100,000	150,000	150,000	200,000	270,000
Shpenzime interesi ankadri														6,779
Shpenzime qiraje	65,000	60,000	20,000											
LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	800,000	1,400,000	106,968	637,852	767,773	943,927	1,200,978	1,201,704	1,513,027	1,018,342	1,010,286	3,009,558	4,804,910	5,111,719
Cash	800,000	1,400,000	0	550,000	650,000	900,000	1,200,000	1,200,000	1,500,000	1,000,000	1,000,000	2,200,000	2,200,000	1,300,000
Llogari A* Bank D*									5,000	5,000	10,000	10,000	10,000	10,000
Llogari tërheqjeje MC R* D*														0
Llogari paze R* D*			148	5,694	17,943	-8,432	169	757	694	2,538	286	799,558	1,094,910	3,801,719
Bono thesari R* D*													1,500,000	
Llogari paze R* OD		103,735	82,158	96,357	467	467	467	467	467	467	0			
Llogari I* OD					51,892	316	429	61	10,261					
Llogari T* B* DC		3,084	0	3,472	0	26	51	6,806	76		0			
Llogari T* Bank OD											0			
Deduarim në DIPP	Para në cash 800,000 lekë. Burimi: Paga dhe të ardhura nga toka bujqësore	600,000 lekë cash (1.1.2004-31.12.2004)		Shuar 450,000 lekë nga shërbimet e autoveturës tip A*/ Të ardhurat nga përdorimi i sip. së toka bujqësore prej 5000 m2. Shuma 100,000 lekë	Shumë të hollash, e krijuar nga produktet e tokës bujqësore përfituar nga ligji 7501 prej 5,000 m2/ Të ruajtura në banesë. Pasuri e shuar. 100,000 lekë	Shuar një shumë të hollash, e krijuar nga të ardhurat prej produkteve të tokës bujqësore prej 5,000 m2. Të ruajtura në banesë. Shuma 250,000 lekë	Shuar një shumë të hollash, e krijuar nga të ardhurat prej produkteve të tokës bujqësore prej 5,000 m2. Të ruajtura në banesë. Shuma 300,000 lekë	Shuar një shumë të hollash, e krijuar nga shërbimet e produkteve bujqësore prej 5,000 m2. Të ruajtura në banesë. Shuma 300,000 lekë	Shuar një shumë të hollash cash, kursime prej totalit të të ardhurave për vitin 2011. Shuma 300,000 lekë.	Pakësuar një pjesë e të hollave të deklaruar si kursime gjendje cash për vitet paraardhëse. Shuma 500,000 lekë.		Shuar likuiditete gjendje në cash, të kursyer nga totalit të të ardhurave familjare të vitit 2014. Shuma 1,200,000 lekë.		Pakësuar totalit të gjendjes cash deklaruar deri në vitin 2015
Analiza dokumentuar	543,104	2,994	1,221,464	180,079	45,489	521,717	514,048	433,098	444,784	690,288	-30,489	-1,225,904	1,300,802	3,799,363

B. KONTROLLI I FIGURËS

11. DSIK-ja, pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, me shkresën nr. *** prot., datë 30.11.2022, ka përcjellë pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 26.10.2017, për subjektin e rivlerësimit Dritan Caka, i deklasifikuar plotësisht (me vendim nr. ***, datë 18.11.2022, të KDZH-së) dhe Grupi i Punës informon se:

- i) *Formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.*
- ii) *Për subjektin e rivlerësimit Dritan Caka nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.*

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Dritan Caka.

Komisioni konstaton se nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke konkluduar po ashtu përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Dritan Caka.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

12. Rivlerësimi profesional, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në raportin e përgatitur nga KLGJ-ja si organi ndihmës për vlerësimin profesional dhe kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit. Ky organ ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 23.12.2021, për subjektin e rivlerësimit Dritan Caka.

12.1 Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja; (ii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; (iii) denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

12.2 Formulari i vetëdeklarimit, i depozituar nga subjekti, paraqitet i plotësuar me saktësi sipas shtojcës së ligjit dhe është nënshkruar rregullisht në çdo faqe.

12.3 Në raportin e KLGJ-së për subjektin e rivlerësimit Dritan Caka janë evidentuar aftësi të mira profesionale, aftësi të mira organizative, aftësi për të kryer procedurat gjyqësore, aftësi për të administruar dosjet, etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, aftësi personale dhe angazhim profesional.

12.4 Në raportin e dërguar nga KLGJ-ja janë analizuar tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

i) Dokumenti 1 – Vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 9.4.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁴⁹, ku subjekti ka gjykuar si gjyqtar i vetëm. Në përfundim të gjykimit është vendosur pranimi i padisë duke u pjesëtuar apartamenti. Vendimi mori formë të prerë, pasi nuk u ankimua nga palët. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 1 vit, 2 muaj e 4 ditë, në shkelje të standardit 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Megjithatë, duhet sqaruar se ky lloj gjykimi zhvillohet detyrimisht në dy faza. Pra, ky proces si rregull është e pamundur të përfundojë i gjithi brenda afatit standard të gjykimit, pasi në vetvete përmbledh dy procese të ndara nga njëri-tjetri. Nga pikëpamja formale, vendimi paraqitet me strukturë të qëndrueshme, janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe (kjo vlen për 8 dokumentet ligjore, që i janë nënshtruar procesit të rivlerësimit në lidhje me kriterin profesional).

ii) Dokumenti 2 – Vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 16.4.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁵⁰, ku subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në trup gjykues me tre gjyqtarë, me relator/kryesues vetë atë. Në përfundim të gjykimit është vendosur pranimi i padisë. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 21.1.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 16.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 8 muaj e 22 ditë, në shkelje të afatit standard 6-mujor.

iii) Dokumenti 3 – Vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 7.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁵¹, ku subjekti ka gjykuar si gjyqtar i vetëm. Në përfundim të gjykimit është vendosur pranimi i padisë. Rezultoi se vendimi mori formë të prerë pa u ankimuar nga palët ndërgjyqëse. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 10 muaj e 7 ditë, në shkelje të afatit standard 6-mujor.

12.5 Pas analizimit të dokumentacionit nga KLGJ-ja është konstatuar se në dokumentin 2⁵² dhe 3⁵³ gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur tej afatit standard 6-mujor, i përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Për konstatimet e mësipërme subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

12.6 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore ka dhënë të njëjtat shpjegime. Në lidhje me dokumentin 2 (gjykimi i të cilit ka zgjatur 8 muaj dhe 22 ditë) dhe dokumentin 3 (gjykimi i të cilit ka zgjatur 10 muaj e 7 ditë), gjykime të cilat janë zgjatur tej afatit standard 6-mujor, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera⁵⁴, se pasi çështjet i janë caktuar për gjykim, ai ka vënë në lëvizje shpejt çështjen, duke planifikuar fillimisht kryerjen e veprimeve përgatitore

⁴⁹ Që i përket çështjes me paditës shtetasit G. dhe M. H. kundër të paditurës E. M. etj., me objekt “Pjesëtim i pasurisë apartament banimi etj.”.

⁵⁰ Që i përket çështjes me paditës shoqërinë “****” sh.a. kundër të paditurit shoqëria “****” sh.a. etj., me objekt “Detyrimi i të paditurit të përmbushë detyrimin kontraktor etj.”.

⁵¹ Që i përket çështjes me paditës I. S., me të paditur shoqërinë “B.” sh.p.k, me objekt “Detyrimi i palës së paditur të përmbushë detyrimin kontraktor etj.”.

⁵² Gjykimi i çështjes ka zgjatur 8 muaj e 22 ditë, në shkelje të afatit standard 6-mujor.

⁵³ Gjykimi i çështjes ka zgjatur 10 muaj e 7 ditë, në shkelje të afatit standard 6-mujor.

⁵⁴ Për detaje shihni përgjigjet në prapësimet e subjektit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

të nevojshme dhe, më tej, ka kaluar në zhvillimin e seancave gjyqësore. Asnjë seancë nuk ka dështuar për faj të gjyqtarit apo mangësive në organizim ose planifikim të tij. Zgjatja e gjykimit ka ardhur si pasojë e këtyre çështjeve me natyrë komplekse, ku janë zhvilluar disa seanca përgatitore, pasi palët në gjykim nuk arrinin të njoftoheshin për shkak të adresave të tyre, janë dashur disa seanca për caktimin e një eksperti, dhënien e detyrave etj., derisa gjykimi është mbyllur përfundimisht. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës dosjet gjyqësore të dy çështjeve të lartpërmendura, ku pasqyrohet e gjithë dinamika e zhvillimit të seancave përgatitore dhe gjyqësore, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

12.7 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse. Nga të dhënat e çështjeve ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë prezent në çdo seancë dhe se shtyrjet e tyre janë bërë për shkaqe objektive, që nuk vareshin prej tij. Subjekti i rivlerësimit ka marrë të gjitha masat procedurale për sa i përket organizimit dhe planifikimit të punës prej tij. Disa seanca kanë dështuar për shkak të pamundësisë së njoftimit të palës së paditur, kompleksitetit të çështjes, mungesës së përfaqësuesit ligjor të palës paditëse, mosparaqitje ekspertësh etj.

Komisioni arrin në përfundimin se zgjatja e gjykimeve tej afatit të standardit 6-mujor ka ardhur për shkak të kompleksitetit të çështjeve dhe shkaqeve objektive të pavarura prej tij. Nuk konstatohen problematika që ta ngarkojnë subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore në lidhje me kriterin profesional.

12.8 Në raportin e KLGJ-së janë analizuar edhe pesë dosjet e përzgjedhura me short, si vijon:

Dosja 1 – Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 21.3.2014⁵⁵, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 15.9.2014. Subjekti ka gjykuar çështjen si gjyqtar i vetëm, duke vendosur pranimin e padisë. Vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë, pasi nuk u ankimua nga palët. Rezultoi se dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore brenda 4 ditësh nga shpallja, duke respektuar afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes është kryer brenda afatit të standardit 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Dosja 2 – Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 23.9.2015⁵⁶, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 16.2.2016. Subjekti e ka gjykuar çështjen si gjyqtar i vetëm, duke vendosur rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala paditëse dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 29.6.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit civil nr. ***, datë 16.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka ushtruar rekurs pala paditëse, por çështja nuk është gjykuar ende. Rezultoi se dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit 10-ditor të parashikuar nga

⁵⁵ Që i përket palës paditëse “****” sh.a. dhe e paditur A. M. etj., me objekt “Detyrimi i të paditurve të paguajnë etj.”.

⁵⁶ Që i përket palës paditëse, shoqërisë “****” sh.p.k., e paditur OSHEE-ja, me objekt “Zgjidhja e kontratave të shërbimit përbarimor etj.”.

neni 308 i Kodit të Procedurës Civile, por jo afatit 5-ditor, pasi është shtyrë shpallja e vendimit. Gjykimi i çështjes është kryer brenda afatit të standardit 6-mujor.

Dosja 3 – Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 26.5.2015⁵⁷, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 23.7.2015. Subjekti ka gjykuar çështjen si gjyqtar i vetëm, duke vendosur pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim personi i tretë, Avokatura e Shtetit dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 10.5.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit civil nr. ***, datë 23.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka ushtruar rekurs pala paditëse, por çështja nuk është gjykuar ende. Rezultoi se dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes është kryer brenda afatit të standardit 6-mujor.

Dosja 4 – Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 24.2.2014⁵⁸, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 22.10.2014. Subjekti ka gjykuar çështjen si gjyqtar i vetëm, duke vendosur pranimin e kërkesës. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim personi i tretë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 21.1.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit civil nr. ***, datë 22.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka ushtruar rekurs pala paditëse, por çështja nuk është gjykuar ende. Rezultoi se dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 7 muaj e 27 ditë, në tejkalim të afatit të standardit 6-mujor, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Nëse do zbritet 1 muaj i lejes vjetore, gjykimi do të konsiderohej i përfunduar brenda afatit 6-mujor.

Dosja 5 – Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 10.6.2016⁵⁹, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 10.6.2016. Subjekti e ka gjykuar çështjen si gjyqtar i vetëm (i gatshëm), duke vendosur pranimin e kërkesës. Vendimi mori formë të prerë, pasi nuk u ankimua nga palët. Rezultoi se dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka përfunduar brenda ditës, duke respektuar afatin 48 orë të përcaktuar nga neni 259, pika 5 e Kodit të Procedurës Penale.

Pas analizimit të dokumentacionit si nga ana e KLGJ-së, ashtu edhe nga Komisioni, nuk janë konstatuar problematika në lidhje me 5 dosjet e përzgjedhura me short për sa i përket kriterit profesional.

12.9 Nga të dhënat arkivore të KLGJ-së, rezulton se gjatë periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, për subjektin Dritan Caka nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin

⁵⁷ Që i përket palës paditëse A. H. etj. kundër AKKP-së, me objekt “Detyrimi i të paditurit të kompensojë në vlerë monetare paditësit etj.”.

⁵⁸ Që i përket kërkuases Xh. Z., me objekt “Kërkohej të korrigjohet emri në librezën e punës etj.”.

⁵⁹ Që i përket kërkuessit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Vlefhtësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë etj. ndaj personit nën hetim A. V.”.

e ish-KLD-së, si dhe nuk rezulton që ndaj tij të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-KLD-ja.

12.9.1 Prokuroria e Përgjithshme⁶⁰ ka përcjellë pranë Komisionit përgjigjet e prokurorive të rretheve gjyqësore⁶¹, që konfirmojnë se pranë tyre nuk rezulton të jenë depozituar kallëzime apo procedime në ngarkim të subjektit Dritan Caka.

12.9.2 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës⁶² ka konfirmuar se pranë saj për subjektin e rivlerësimit Dritan Caka është regjistruar materiali hetimor nr. ***, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ku Prokuroria, pas veprimeve hetimore të kryera, ka konkluduar se fakti i referuar nuk përbën veprë penale dhe në përfundim është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit.

12.9.3 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë⁶³ ka konfirmuar se pranë saj për subjektin e rivlerësimit Dritan Caka është regjistruar materiali hetimor nr. ***, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ku nga Prokuroria është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit. Kallëzuesi e ka ankimuar vendimin e mosfillimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila me vendimin nr. ***, datë 13.12.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kallëzuesit.

12.9.4 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶⁴ ka konfirmuar se pranë saj për subjektin e rivlerësimit Dritan Caka është regjistruar materiali hetimor nr. ***, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ku nga Prokuroria është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit.

12.9.5 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier⁶⁵ ka konfirmuar se pranë saj është regjistruar materiali hetimor nr. ***/2016, ku subjekti T. H. dhe Dritan Caka kanë depozituar kallëzim pranë kësaj prokurorie për veprën penale “shpifje për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 240/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit R. Xh. Në përfundim të hetimit, prokurori ka dërguar kërkesën për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

DENONCIMET/ANKESAT E DEPOZITUARA NGA PUBLIKU

12.10 Pranë Komisionit ndaj subjektit të rivlerësimit Dritan Caka janë depozituar 21 denoncime/ankesa nga publiku.

⁶⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 4.3.2021, e Prokurorisë së Përgjithshme.

⁶¹ Kthim përgjigjet e prokurorive të rretheve gjyqësore: Elbasan, me nr. *** prot, datë 14.12.2020; Krujë, me nr. ***prot., datë 24.12.2020; Pukë, me nr. *** prot., datë 10.12.2020; Berat, me nr. *** prot., datë 7.12.2020; Mat, me nr. *** prot., datë 11.12.2020; Kurbin, me nr. *** prot., datë 7.12.2020; Tropojë, me nr. *** prot., datë 7.12.2020; Përmet, me nr. *** prot., datë 15.12.2020; Gjirokastrë, me nr. *** prot., datë 10.12.2020; Kukës, me nr. *** prot., datë 9.12.2020; Sarandë, me nr. *** prot., datë 11.12.2020; Korçë, me nr. *** prot., datë 11.12.2020; Pogradec, me *** prot., datë 5.2.2021; Dibër, me nr. *** prot., datë 14.12.2020; Lezhë, me nr. *** prot., datë 10.12.2020; Shkodër, me nr. *** prot., datë 14.12.2020; Lushnjë, me nr. *** prot., datë 9.12.2020; Vlorë, me nr. *** prot., datë 21.12.2020.

⁶² Përgjigje nr. *** prot., datë 11.1.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

⁶³ Përgjigje nr. *** prot., datë 31.12.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

⁶⁴ Përgjigje nr. *** prot., datë 9.2.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁶⁵ Përgjigje nr. *** prot., datë 14.12.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier.

12.10.1 Nga analizimi i këtyre denoncimeve rezultoi se 9⁶⁶ prej tyre nuk plotësonin kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, pasi denoncuesit nuk kanë referuar rrethana konkrete, veprime specifike, nuk ka dokumentacion provues apo që të krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore nga ana e subjektit të rivlerësimit.

12.10.2 Për 9⁶⁷ denoncime të tjera, Komisioni, pasi i analizoi ato, dokumentacionin e depozituar prej tyre, si dhe dokumentacionin e administruar prej tij, rezultoi se pretendimet e denoncuesve për “vendim të padrejtë” kanë të bëjnë me themelin e çështjes/vendimmarrjen e subjektit, për të cilën Komisioni mban parasysh nenin 72 të ligjit nr. 96/2016.

12.10.3 Në lidhje me dy denoncimet e mëposhtme pretendohet për shkelje procedurale, konkretisht:

a. Denoncimi nr. * prot., datë 7.12.2018**, i shtetasit Gj. Ll. – në formularin e denoncimit, tek rubrika “aftësitë profesionale”, denoncuesi ka plotësuar kuadratin “zvarritje në proces” me “po”. Denoncuesi i ka bashkëngjitur vendimin nr. ***, datë 29.10.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, i dhënë nga subjekti Dritan Caka për çështjen me të pandehur Th. K., i akuzuar për veprën penale “shkaktim i vetëvrasjes”, ku në përfundim të gjykimit subjekti ka vendosur: *“Të deklarojë të pafajshëm të pandehurin Th. K. për veprën penale “shkaktim i vetëvrasjes” së ish-bashkëshortes së tij E. P., parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, pasi nuk provohet që fakti i veprës penale ekziston”*. Ky vendim është bërë objekt ankimi edhe në gjykatat më të larta⁶⁸.

⁶⁶ (1) Nr. *** prot., datë 15.12.2017, i shtetasit H. A., i cili pretendon se subjektet I. T., B. M., K. G. dhe subjekti Dritan Caka e kanë zvarritur për 10 vite nëpër procese gjyqësore; (2) nr. *** prot., datë 26.2.2018, i shtetasit L. A., i cili pretendon se prokurorja S. S., të cilën e ka kufitare në një pronë e cila është në proces gjyqësor, ka njohje me gjyqtarin Dritan Caka; (3) nr. *** prot., datë 24.3.2020, i shtetasit Z. E., i cili ngre pretendimin se subjekti i rivlerësimit gjatë kohës që ka qenë anëtar i ish-KLD-së ka promovuar veten duke u vetëmëruar gjyqtar i Tiranës, gjë që ligji ia ndalon; (4) pesë denoncime (nr. *** prot., datë 10.5.2021, nr. *** prot., datë 28.7.2020, nr. *** prot., datë 15.1.2020, nr. *** prot., datë 6.12.2019 dhe nr. *** prot., datë 22.5.2019) të shtetasit S. T., i cili pretendon se 24 subjekte, duke përfshirë subjektin Dritan Caka, të cilët kanë gjykuar çështje gjyqësore ku ai ka qenë palë, kanë shpërdoruar detyrën; (5) nr. *** prot., datë 14.10.2022, kërkesë e shtetasve E. dhe Sh. S., të cilët ia drejtojnë gjyqtarit të çështjes Dritan Caka, ku kërkuesit janë palë në këtë gjykim dhe vënë Komisionin për dijeni.

⁶⁷ (6) Nr. *** prot., datë 12.10.2018, i autoritetit AMF, i cili pretendon se nga subjekti Dritan Caka, si gjyqtar i çështjes, është marrë vendim në interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit të pambështetur në prova; (7) nr. *** prot., datë 5.12.2018, i shtetasit Z. P. (administrator i shoqërisë “****” sh.p.k.), i cili pretendon se subjekti Dritan Caka ka dhënë vendim të padrejtë; (8) nr. *** prot., datë 3.2.2020 dhe nr. *** prot., datë 6.2.2020, i shtetas N. B., e cila pretendon se nga subjekti Dritan Caka është dhënë vendim i padrejtë; (9) nr. *** prot., datë 16.5.2019, i shtetas E. B., e cila pretendon sjellje jokorrekte nga gjyqtari Dritan Caka, i cili ka dhënë vendim të gabuar; (10) nr. *** prot., datë 20.11.2019 dhe nr. *** prot., datë 17.5.2021, i shtetasit L. S. (administrator i shoqërisë “****” sh.a.), i cili pretendon se nga gjyqtarët A. G., A. C. dhe Dritan Caka ka shkelje të ligjit për vendimin e dhënë në disfavor të tij; (11) nr. *** prot., datë 19.12.2022, i shtetasit P. N., i cili pretendon se gjyqtari Dritan Caka, i cili ka gjykuar një çështje civile ku denoncuesi ishte palë, ka dhënë një vendim të padrejtë kundër tij, duke i rrëzuar padinë; (12) nr. *** prot., datë 12.9.2018, i shtetasit A. Rr., që pretendon se nga subjekti Dritan Caka, i cili ka gjykuar një çështje civile ku denoncuesi ishte palë, ka shmangie të qëllimshme të detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit Tiranë.

⁶⁸ Ndaj këtij vendimi është bërë ankimi në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. *** regj., datë 24.3.2004, ka vendosur “Mospranimin e ankimit, pasi nga prokurori i Apelit ishte hequr dorë nga ankimi i bërë nga prokurori i Shkallës së Parë”. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë, me objekt “Rishikim i vendimit nr. ***, datë 29.10.2003”, ku në përfundim të gjykimit Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 11.9.2009, ka vendosur “Mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr. ***, datë 29.10.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, të paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Lushnjë”.

a/i. Lidhur me pretendimin e denoncuesit për zvarritje procesi, Komisioni ka administruar dosjen gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë⁶⁹, nga ku ka rezultuar se çështja i është caktuar për gjykim gjyqtarit Dritan Caka në datën 20.1.2003 dhe ai ka caktuar seancën e parë gjyqësore në datën 5.2.2003. Në datën 29.10.2003, subjekti Dritan Caka ka dhënë vendimin e lartpërmendur në lidhje me këtë çështje. Gjykimi i kësaj çështjeje ka zgjatur rreth 8 muaj, brenda afatit 9-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

b. Denoncimi nr. * prot., datë 19.1.2018**, i shtetasit A. A., që pretendon për njëanshmëri, gjykim të padrejtë, zvarritje procesi, duke i bërë favorizime palës tjetër, ka pranuar kërkesën e palës së paditur në formën e kundërpadisë, pala kundërpaditëse ka paraqitur një dokument fotokopje, pra jo në formën e kërkuar nga ligji, duke shkelur haptazi ligjin procedural etj., nga gjyqtari Dritan Caka. Denoncuesi ka shpjeguar se u detyrua të tërhiqej nga vazhdimi i gjykimit.

b/i. Për të vërtetuar pretendimet e denoncuesit, Komisioni ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷⁰ dosjen civile të çështjes me paditës L. A. dhe të paditur Sh. A. etj., me objekt “Pjesëtim i pasurisë së përbashkët, tokës arë me sip. 14,500 m²”, e gjykuar nga subjekti Dritan Caka.

b/ii. Për pretendimin e denoncuesit për zvarritje procesi, nga aktet e dosjes ka rezultuar se janë zhvilluar 15 seanca përgatitore dhe gjyqësore dhe kjo kohëzgjatje ka ardhur për shkak të marrjes pjesë në gjykim të disa palëve dhe për shkak të problematikës në lidhje me njoftimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme për shkak të problemit me adresat. Zgjatja e procesit nuk ka ardhur për shkaqe që varen nga subjekti Dritan Caka.

b/iii. Për pretendimin e denoncuesit se nga pala e paditur është depozituar si provë AMTP fotokopje në kundërshtim me ligjin, nga aktet në dosje ka rezultuar se pala e paditur e pranon vetë që ka fotokopje dhe jo dokument origjinal dhe i kërkon gjykatës që t’i drejtohet organit përkatës për të konfirmuar vërtetësinë e këtij dokumenti.

b/iv. Pretendimi për favorizim të palës tjetër pse i ka pranuar kundërpadinë, nuk qëndron, për faktin se kundërpadia është mjet ligjor, i cili mund të përdoret në një proces gjyqësor dhe vendoset nga gjykata nëse pranohet apo jo.

b/v. Për pretendimin për njëanshmëri, nga aktet ligjore rezulton se në procesverbalin e seancës përgatitore të datës 14.1.2016, kur është verifikuar prezenca e palëve, ka rezultuar se paditësi L. A. dhe avokati i tij nuk janë paraqitur në gjykim, ndonëse kanë pasur dijeni për seancën e kësaj date dhe nga pala e paditur është kërkuar pushimi i gjykimit, ndërsa gjykata ka vendosur ta shtyjë atë për një datë tjetër, që t’i jepte mundësi palës paditëse të paraqitet në gjykim. Pra, në këtë rast, gjykata ka favorizuar paditësin L. A. dhe jo të paditurin, ndryshe nga sa është pretenduar nga denoncuesi. Po kështu, edhe në seancën përgatitore të datës 1.12.2016, duke qenë se paditësi L. A. nuk kishte dijeni për këtë seancë, gjykata vendosi ta shtyjë seancën dhe ta njoftojë edhe një herë paditësin. Në seancën e datës 27.1.2017 nuk u paraqit paditësi L. A. dhe avokati i tij, edhe pse

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 19.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

⁷⁰ Përgjigje nr. *** prot., datë 30.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

kishin dijëni nga seanca e mëparshme dhe, në këto kushte, gjykata vendosi pushimin e gjykimit, konform Kodit të Procedurës Civile, ashtu sikurse vetë denoncuesi L. A. e pranon që u tërhoq nga gjykimi. Nuk rezultoi që ky vendim të jetë ankimuar nga palët.

Komisioni ka konstatuar se për dy denoncimet e analizuara më sipër, pretendimet e denoncuesve për zvarritje të procesit, për favorizim të palës tjetër etj., nuk qëndrojnë, për sa kohë gjyqtari Dritan Caka ka kryer veprime të plota procedurale dhe është menaxhuar objektivisht kohëzgjatja e këtyre gjykimeve. Nuk ka *indicie* për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore për sa i përket kriterit profesional.

12.10.4 Në lidhje me denoncimin nr. *** prot., datë 4.6.2021, avokat S. I., përfaqësues i shtetasës Z. I. etj., pretendon se nga gjyqtari Dritan Caka janë kryer shkelje të rënda procedurale dhe materiale. Denoncuesi i ka bashkëngjitur ankesës së tij vendimin nr. ***, datë 21.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe vendimin nr. *** regj., datë 7.1.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga analiza e dokumentacionit, rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë është gjykuar çështja civile me palë paditëse Z. I. etj., e paditur shoqëria “****” sh.a., me objekt “Shpërblim dëmi jashtëkontraktor etj.”. Në përfundim të gjykimit është vendosur: “1. Pranimi i kërkesëpadisë; 2. Detyrimi i palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen Z. I. për dëmin pasuror dhe jopasuror në vlerën 13,151,921 lekë etj.; 3. Dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm”.

Pas këtij vendimi, paditësja Z. I. etj. ka kërkuar vënien në ekzekutim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë nëpërmjet përmbaruesit G. B., i cili ka bërë njoftim për ekzekutim vullnetar dhe më pas është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm. Të nesërmen e vendimit të përmbaruesit për ekzekutim të detyrueshëm, pala debitore “****” sh.a. i është drejtuar kësaj gjykate për pezullimin e veprimeve përmbarimore, e cila me vendimin nr. *** regj., datë 7.1.2021 (vendim i dhënë nga subjekti Dritan Caka), ka vendosur: “1. Pranimin e kërkesës ankimore; 2. Anulimin e veprimeve përmbarimore të kryera nga përmbaruesi G. B. për vënien në ekzekutim të vendimit nr. ***, datë 21.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; 3. Pezullimin e veprimeve të mëtejshme përmbarimore për vënien në ekzekutim të vendimit nr. ***, datë 21.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë”.

Ky vendim është ankimuar nga përmbaruesi G. B. në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 28.4.2021, ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. *** akti, datë 7.1.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe kthimin e çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë me tjetër trup gjykues”. Gjykata e Apelit Tiranë, ndër të tjera, ka argumentuar dhe vlerëson se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është i pabazuar në ligj dhe në prova dhe i marrë në shkelje të rregullave bazë procedurale.

Përmbaruesi G. B. nuk ka qenë dakord me vendimin nr. ***, datë 28.4.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë (e cila vendosi kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë me tjetër trup gjykues) dhe ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, me argumentin se kjo e fundit duhet ta kishte gjykuar çështjen në fakt dhe jo ta kishte kthyer për

rigjykim, pasi vetëm duke i dhënë zgjidhje mosmarrëveshjes ajo do mund të garantonte respektimin e të drejtave të palëve dhe procesin e rregullt ligjor.

Nga ankuesi, bazuar në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, në denoncim janë referuar shkeljet procedurale nga subjekti Dritan Caka, si vijon:

i) Gjykata e Shkallës së Parë ka kryer shkelje të rregullave procedurale kur ka vijuar gjykimin dhe dhënien e vendimit përfundimtar pa njoftuar palët për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi.

ii) Konform nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile, kjo gjykatë nuk ka mbajtur procesverbal të përmbledhur me shkrim për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi.

iii) Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka marrë parasysh paragrafin II të nenit 203 të Kodit të Procedurës Civile, i cili ndalon zbatimin e rregullave të sigurimit të padisë për paditë apo kërkesat që ngrihen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm. Gjykata nuk i ka krijuar mundësitë minimale për t'u dëgjuar dhe mbrojtur personit të tretë, përmbaruesi gjyqësor privat G. B. (veprimet e të cilit kundërshtoheshin).

iv) Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka krijuar mundësinë minimale për t'u dëgjuar dhe mbrojtur interesat e personit të tretë, përmbaruesit gjyqësor G. B. (veprimet e të cilit kundërshtoheshin).

v) Gjykata e Shkallës së Parë ka administruar si provë një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, i cili nuk përmbush asnjë kriter për t'u administruar si provë shkresore, pasi dukshëm ka dalë nga sistemi elektronik i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë pa të dhënat e domosdoshme të sigurisë (nënshkrimi i gjykatës dhe vula e gjykatës).

vi) Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka përcaktuar në vendimin e saj cilin veprim përmbarimor ka anuluar dhe nuk i ka krijuar mundësi përmbaruesit gjyqësor të japë mendim për kërkesën ankimore dhe të paraqesë provat e veta në drejtim të vlerësimit, nëse kërkesa ankimore ishte e bazuar apo jo në ligj e në prova.

vii) Gjykata e Shkallës së Parë duhet të kishte konstatuar se ankimi, i cili nuk përmbushte kriteret formale, ajo konform neneve 450 - 455 të Kodit të Procedurës Civile duhet ta konstatonte ankimin me të meta dhe t'i lërë afat 5 ditë ankuesit që t'i ndreqë ato, në të kundërt vendoset mospranim ankimi.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, iu kërkuan të provoje të kundërtën e rezultateve të hetimit.

12.10.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka dhënë të njëjtat shpjegime. Ai ka shpjeguar, ndër të tjera⁷¹, se:

- Përpara se të ndryshonte neni 601 i Kodit të Procedurës Civile, parashikohej që “*Kundërshtimi i veprimeve përmbarimore të bëhej në formën e një gjykimi me palë kundërshtare përmbaruesin gjyqësor, pasi kjo gjë parashikohej në paragrafin 4 të këtij neni*”. Ndërkohë që, në kohën e dhënies

⁷¹ Për detaje shihni prapësimet e subjektit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni.

së vendimit objekt denoncimi, rezulton se shqyrtimi i çështjeve civile, me objekt “Kundërshtimin e veprimeve përbarimore”, parashikohet si gjykim i një natyre të veçantë me karakter të ngutshëm, ku nuk gjejnë zbatim rregullat e përgjithshme të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Ndryshimet e bëra në vitin 2016, në nenin 601 të Kodit të Procedurës Civile, nuk parashikonin më detyrimin për të thirrur si palë të paditur përbaruesin gjyqësor, ndërkohë që në dispozitë parashikohet se *“Palët thirren për t’u dëgjuar vetëm kur këtë gjë e vlerëson gjykata të nevojshme”*.

- Subjekti ka shpjeguar se praktika e kolegjeve të ndryshëm të Gjykatës së Apelit Tiranë, për raste analoge, nuk ka qenë e unifikuar, pasi në raste të tjera ka lënë në fuqi vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku është ndjekur e njëjta procedurë gjykimi, pra pa u njoftuar palët dhe pa u mbajtur procesverbal⁷². Nga përbaruesi gjyqësor ndaj këtij vendimi është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, i cili nuk është shqyrtuar ende. Në këto rrethana, duhet të mbahen parasysht kriteret e nenit 135/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se *“Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë që krijohen me ligj [...]”*. Deri më sot, Gjykata e Lartë nuk ka nxjerrë ndonjë vendim unifikues apo njësesues, ku të përcaktohet se për gjykimin e çështjeve të kësaj natyre duhet të njoftohen palët për ditën dhe orën e marrjes në shqyrtim të çështjes, si dhe t’u jepet atyre mundësia për paraqitjen e provave, në respektim të parimit të kontradiktoritetit apo të mbahet procesverbal, siç parashihet në vendimin nr. ***, datë 28.4.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Nëse Gjykata e Lartë do të mbajë në vijim një qëndrim të caktuar në lidhje me procedurën e gjykimit të kësaj kategorie çështjesh, atëherë mund të ndryshojë edhe praktika e gjykimit të tyre në gjykatën e shkallës së parë.

- Në lidhje me konstatimin për mosmbajtjen e procesverbalit për gjykimin e kësaj çështjeje, neni 118 i Kodit të Procedurës Civile parashikon që procesverbali mbahet si rregull vetëm në formën me regjistrim audio dhe kjo dispozitë nuk parashikon në përmbajtje të saj “mbajtjen e ndonjë procesverbalit të përmbledhur me shkrim për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi”.

- Pretendimi në denoncim se prej gjykatës nuk është marrë parasysht rregulla e parashikuar në nenin 203/2 të Kodit të Procedurës Civile, e cila ndalon zbatimin e rregullave të sigurimit të padisë për paditë apo kërkesat që ngrihen në fazën e ekzekutimit, nuk është i vërtetë. Duke iu referuar përmbajtjes së vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit Dritan Caka, rezulton më se e qartë që gjykata në këtë rast nuk ka marrë ndonjë masë për sigurimin e padisë, sikurse pretendohet në denoncim, por është marrë pikërisht masa e pezullimit të veprimeve të mëtejshme përbarimore, ashtu sikurse parashikohet në nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo masë (e pezullimit të veprimeve përbarimore) është marrë në kuadër të shqyrtimit në dhomë këshillimi të një ankimi

⁷² Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës vendimin nr. ***, datë 24.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i dhënë nga gjyqtari F. K. në çështjen me ankues DPQ Nr. ***, person i tretë shoqëria përbarimore E, me objekt “Kundërshtimi i veprimeve përbarimore të shoqërisë E” dhe, në përfundim, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Është bashkëngjitur edhe vendimi nr. ***, datë 27.5.2019, i Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 24.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

kundër veprimeve përmbarimore, sipas procedurës së posaçme, të parashikuar nga neni 610 i Kodit të Procedurës Civile, siç është parashtruar më lart.

- Në lidhje me pretendimin e ngritur në denoncim, se gjykata nuk i ka krijuar mundësinë minimale për t'u dëgjuar dhe mbrojtur interesat e personit të tretë përmbaruesit gjyqësor G. B. (veprimet e të cilit kundërshtoheshin), duke mos u mbajtur parasysh sa përcaktohet në vendimin nr. ***, datë 19.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese, duhet evidentuar se nga kjo pikë e denoncimit rezulton se denoncuesi (si avokat) dhe personat që përfaqëson nuk kanë qenë palë në vendimin e prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë, ndërkohë që neni 610 i Kodit të Procedurës Civile në mënyrë të qartë nuk parashikon detyrimin e gjykatës që t'i njoftojë ata në çështjet me objekt "Kundërshtimi i veprimeve përmbarimore", pasi thirrja e palëve të tjera pjesëmarrëse në procedurën përmbarimore parashikohet nga kjo dispozitë vetëm për rastet kur gjykata e vlerëson të nevojshme.

- Në lidhje me pretendimin se gjykata e shkallës së parë ka administruar si provë një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, që nuk përmbush asnjë kriter për t'u administruar si provë shkresore, pasi dukshëm ka dalë nga sistemi elektronik i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë pa të dhënat e domosdoshme të sigurisë, subjekti ka shpjeguar se administrimi i kësaj prove në formën e pretenduar në denoncim nuk është vlerësuar i nevojshëm në këtë rast, pasi përmbajtja e pjesës urdhëruese të këtij vendimi ishte pasqyruar në veprimet përmbarimore të kryera nga përmbaruesi që i ishin njoftuar palës që kishte paraqitur ankimin në formën e tyre origjinale, gjithashtu nga denoncuesi nuk pretendohet se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë ka përmbajtje tjetër nga ai i pasqyruar në vendimin objekt denoncimi.

- Në lidhje me pretendimin se gjykata nuk ka përcaktuar në vendimin e saj cilin veprim përmbarimor ka anuluar dhe nuk i ka krijuar mundësi përmbaruesit gjyqësor të japë mendim për kërkesën ankimore dhe të paraqesë provat e veta në drejtim të vlerësimit nëse kërkesa ankimore ishte e bazuar apo jo në ligj, subjekti ka shpjeguar se në përmbajtje të pjesës arsyetuese të vendimit del e qartë se cilat veprime përmbarimore ishin kryer nga përmbaruesi gjyqësor G. B. për vënien në ekzekutim të përkohshëm të vendimit nr. ***, datë 21.12.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

- Në lidhje me argumentin se gjykata e shkallës së parë duhet të kishte konstatuar se ankimi i cili nuk përmbushte kriteret formale, ato konform neneve 450 - 455 të Kodit të Procedurës Civile, duhet ta konstatonte ankimin me të meta dhe t'i lërë afat 5 ditë ankuesit që t'i ndreqë ato, në të kundërt vendoset mospranim ankimi, subjekti argumenton se nga ana e tij nuk janë konstatuar mospërmbushje të kriterëve formale të ankimit kundër veprimeve përmbarimore. Për këtë shkak, ka vlerësuar se nuk kishte vend për ta konsideruar këtë ankim me të meta.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

12.10.6 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme. Për pretendimet e denoncuesit të bazuara në vendimin e Gjykatës së Apelit, që kishte të bënte me aspekte procedurale, subjekti i ka shpjeguar ato me detaje, duke bërë referimet e dispozitave ligjore me ndryshimet përkatëse sipas kohës. Subjekti ka analizuar pretendimet, të cilat ishin objekt

denoncimi bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, në praktikat gjyqësore të ngjashme, i udhëhequr edhe nga bindja e tij e brendshme, si dhe nga vlerësimi individual i provave dhe i fakteve të këtij gjykimi. Ndonëse nga ana e Gjykatës së Apelit në dukje janë evidentuar mangësi procedurale, subjekti i ka argumentuar qartë ato, duke e vënë theksin dhe në atë që do të vendoset në gjykimin e kësaj çështjeje në Gjykatën e Lartë⁷³, meqenëse edhe përmbaruesi G. B. nuk ishte dakord me vendimin e Gjykatës së Apelit dhe bëri rekurs ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Lartë, në mungesë të unifikimit të një praktike gjyqësore, për sa kohë edhe kolegje të ndryshme të Gjykatës së Apelit për çështje të ngjashme kishin mbajtur qëndrime të ndryshme. Gjithashtu, Komisioni mban parasysh edhe faktin që përmbaruesi G. B. nuk ka qenë dakord me vendimin e Gjykatës së Apelit (ku kishte mbështetur pretendimet e denoncuesit për shkelje procedurale) dhe, më pas, ka kundërshtuar këtë vendim në Gjykatën e Lartë, pasi Gjykata e Apelit duhet ta kishte gjykuar në themel dhe ta zgjidhte përfundimisht çështjen dhe jo ta kthente për rigjykim, duke evidentuar kështu qëndrimin joreal/koherent të denoncuesit (avokatit), të bazuar tek veprimet e përmbaruesit G. B., se Gjykata e Apelit kishte të drejtë, duke denoncuar shkelje procedurale.

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim bazuar në provat dhe faktet e këtij gjykimi dhe i udhëhequr nga bindja e tij të brendshme, për të cilin Komisioni mban parasysh nenin 72 të ligjit nr. 96/2016, pa e ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore për sa i përket aspektit profesional.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Dritan Caka:

- a) Ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, duke rezultuar me një pamundësi financiare në shumën -56,393 lekë, vlerë kjo e papërfillshme sa ndaj tij të mos aplikohet ndonjë masë disiplinore.
- b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c) Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

⁷³ Subjekti ka depozituar rekursin e bërë nga përmbaruesi G.B. në Gjykatën e Lartë, si dhe ekstraktin e printuar nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë www.gjykataelartë.gov.al për çështjen në fjalë, e cila ende nuk është gjykuar.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirëkualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Dritan Caka, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 23.5.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj